



SHPATA NË LULISHTE

ABDYLAZIS ISLAMI

POEZI E SIMBOLIT TË MENDIMIT TË VISIT DHE E FILOZOFISË POETIKE TË UNIVERSIT

Me këtë vëllim poetik me titull “Shpata në lulishte” të poetit Abdylaziz Islami shënohet gjithsesi një ngritje e re ideoartistike letrare dhe estetike e subjektit poetik si në planin individual krijues të këtij poeti, por kjo do të ketë rrezatim avancues edhe në mbarë poezinë e sotme shqipe dhe më gjerë. Ky vëllim me poezi përbëhet nga nëntë cikle tematike e motivore, që si strukturë e tërësishme e këtij libri rrumbullakohet me idetë e realizuara të simbolit të mendimit të visit dhe të filozofisë poetike të universit. Janë stisur në këto vargje shqetësime dhe vibrime shpirtërore me rrënjët e ngulitura thellë në tokën e vendlindjes dhe ato ushqejnë trungun dhe tërë pemën e mendimeve që projektojnë deri në përmasat e universit me një gjuhë dhe sintaksë origjinale poetike të një stili të mëvetësishëm të Abdylaziz Islamit. I tërë figuracioni, harmonia e brendshme strukturore poetike ndërtohen përmes një përvoje të pasur nga ky autor, duke krijuar kështu një sistem poetik me kode të menduara dhe të realizuara poetike. Depërtimi përtej velit metafizik filozofiko-poetik është linjë përshkuese që metaforën e bën të jetë me më tepër kuptim apo nocion të notës poetike pa ekuivoke të rastit. Të gjitha këto gërshetohen që të shprehen herë-herë edhe me një alegori e ironi të hollë, e cila nuk vret rëndë, por ajo përvëlton dhe djeg brendinë e subjekteve lirike të së keqes.

Marrë në tërësi, poezitë e këtij vëllimi poetik kanë një renditje të menduar mirë nëpër cikle, si dhe kanë renditje kuptimore ndërlydhëse brenda cikleve. Gjuha është e pasur dhe ka nuancat e veta origjinale me një laryshi sintagmash poetike por që kodifikohen bukur me idiomat e freskëta dhe origjinale, të cilat kanë mbështetje në burimin e tyre popullor burimor.

*Mr. Ramadan Sinani
Tetovë, 26.09.1993*

I OAZA E FLIJIMEVE

NOCTURNUS NË OENEUM ¹

1.

Artati ² buron nga sytë e mi
E një zhaurimë e njohur në hapësirë
Rrëkëllehet nëpër rrëpinat e kohës:
Tokën e dridh nën këmbë
Dhe qiellin e përplas mbi kokë.

T'i jepet jetë të zëshmes,
T'i jepet zë të pazëshmes.

Kujtimi e vë në dorë masivin e shekujve
Dhe djeg zjarri i vetëdijësimit.

Si mund ta ndjesh ndryshe
Respektin ndaj të dashurës
Në të të padashurën,
Që ndjell karkalecat e zjarrit?

2.

Përbuzet parajsa që lind nga lavdet,
Në ajër farsat e pajetuara ende
Do t'i thithësh një nga një
Dhe do ta jetosh të papërjetuarën.
E do të bindesh se guri është i flashkët

Para dimrave të grathët
Që të kanë kërthnezur
Nga prushi i akullit.

Duart e nënave kanë përkundur
Me tingujt e ndjeshëm të ninullave

Me puçra në buzë,
Me halë në sy,

Gjékundi pranë Oeneumit të Paionëve
Të cilin e përkëdhel Artati shkumues
Që zbret lodhshëm nga Skardi ³.

1. Oeneum-mi, ose si e ka quajtur populli ndryshe Qenej në mileniumin e parë para erës së re Tetovën e sotme.

2. Artat-ti - lumi që e ka përshkuar Oeneumin (Qenejin).

I Skirëtarëve⁴ të ngarkuar rëndë

Me qiellin në shpinë
Dhe brengat e shpatieve në zemër.

Skirëtarët na e lanë prushin në dorë
Për diç të paarritur, të mos harrohet
Si bëhet përpjekja të harrohet dita
Që s'është e pëlqyeshme për shumëçka.

3.

Ditët ters kanë mugulluar nëpër shekuj
E janë brumosur në frymëmarrjen
E kujtimeve të rëzbitura

Me mavijosje sysh,
Për një pritje
Që nuk i soset lëmshi.

Prej kohësh katarzë shtrydhen plagët,
Shpalohen varret e katandisura,
Zbulohen lapidarët pa u bërë homazhe,
E numrit të tyre nuk mund t'i dalë zot lapsi,
Sa mund t'u dalë yjeve në qiell,
Ose rërës së shëndoshë në fund të lumit,

Ku gatuhet ëndrra e qëndresës,
Ku përjetohet mençuria e durimit,
Ku mbijetesa i jep lëng jetës.

Sa më larg keqprekjeve,
Sa më larg keqndjekjeve.

Këmishën e qiellit e vesh nata
Dhe shitet për korife të rrallë
Stolisur me gurë të çmueshëm
Që shkëlqejnë të gjallë e të përjetshëm,
Duke na pëshpëritur
Për gjenezën tonë të lashtë.

4.

Genti s'diti sa e çmoi Skirëtari Skardin,
As sa peshoi Oeumei n'Pollog:

Në kraharor hënën nuk ia pa,
Mbase as diellin në ballë -

³ Skardi (Scardus) - mali Sharr mbi Tetovë në kohën e ilirëve.

⁴ Skirëtarë-ët - fis i vogël ilir që i ka takuar vetëm Skardit.

E rrafshoi me zjarr e katapulta
Dhe, që ta pagëzojë me emër tjetër themelues,
Përdori tetë hovet e tij në Arenë
Që ta emërtojë përjetë me emrin Tet'-hov
Dhe shkeli nëpër gjak të kohës
E nëpër kufoma baladash e legjendash
E u sëmur për vdekje
Nga mërzia për të vëllezërit
Që ranë të gabuar, të shëmtuar,
Pse nuk qenë bashkë me labiatët
në një ëndërr të përbashkët.

Se kush i tha të përdorte barërat shëruese,
Lulja Gentiana që amalgam për shëndetin e tij.

Gentët e Gentianat lindën ndër Skirëtarë
Që të anatemohen prindërit e tyre në pakohësi.

Paraku që jetonte me frute të gatshëm,
Shpiku një përrallë për emrin e qytetit
Dhe u përpoq erën e vet ta njësonte me të tijën.

Të pëlqen në këtë rast mashtrimi
T'i mbushësh veshët me shindër
Dhe sytë t'i mbulosh me duar?

Shekulli ynë është një kalesë e ngushtë
Nëpër dendësitë e fjalëve të pamatura,
Si frika, si rrena, si përgjumja e guximit
Nëpër ditët e papërkufizuara n'logjikë.

5.

Në gji të lumenjve peshqit alivanosen,
Në gji të qiellit zogjtë përpëliten,
Në krahët e jetës bohçet e trastat e rënda

Të mbushura me lutje
Dhe thirravaje fëmijësh

Deri përtej kodrave ku bren miza hekur.
Në Golgotë të diasporave - anekënd

Nga poli në pol
Dëgjohet një zë mallëngjyes

Të cilin e përgjon vetmia e stepur.

E në horizont, gjëkund,
Butthohet shtëpia
E qulluar nga shiu i nxehtë
I mërzisë së gjatë

Në të cilin lahet brenga për jetën

Me anëtarë të ndarë,
Me shpirt të mpirë,
Me shpresa të mugëta,
Me vullnete të papara për rrojtjen,
Me zemër të shtrydhur në mes kodrash,
Me ardhmëri të mjegulluar.

6.

Oeneumi pas tetë hoveve e ndërroi emrin,
Kurse në histori edhe ëndrra e vdekshme

Me qindra e mijëra herë
E ndërroi pamjen e vjetër me të renë,

Duke ushqyer të vetmen dëshirë
Për martesën e Gentit
Me Euridikën e Paionëve,
Për të parë jetën biri i tyre Dritoni
Në ditëlindje t'i loznin Skirëtarët

E të deheshin
Në dritën e shpresës së mirë,

Që të pikasë se në kaçorret tona
Përkundet ndër këngë dashuria.

Dhe në ne llamburit drita e nurit,
Apo mbase në zemër rritet brinci
Xixat e të cilit shkrepin në sy
Dhe dridhet paraku hidhërak
Që ndërton avenirin nëpër degë.

E deti i ri që rrudhet
Nuk plaket nga mosha,
Po nga kapriçet,

Nga dëshira për të qenë vetjak
Si meduza gllabëruese,
Si peshkaqeni i dehur nga fuqia
Me kohë të pangirë kurrë

Gëlltit atomet e jetës

Shkëputur nga prona e detit të vjetër
Që ruan në gji dashurinë e pamatur
Dhe në kujtesë mbamendjen e kthjellët,
Për t'ua pëshpëritur në vesh kërkesat

Për bashkimin e bukurezave,
Për hënën e përbashkët e të plotë
Dhe në pemën e saj sharton përjetësinë

Me kujdesin e devotshëm
Të duarve që shtohen!

7.

Oeneumi me bukuri të tmerrshme,
Deri në themel u rrafshua
Nga dora e birit të gjakut të vet,
Me emrin e ri arkaik jeton
Në pafundësinë e pritjeve
Të mbarsura me dëshira
Për jetë të lirë...

Një zë i ngjizur, ja,
Duket se thërret?!

(2 nëntor 1990)

ËNDRRAT BULOJNË NË EL DORADO

1.

Me dashuri hipa në majë të lartë
Të Sharrit, si Homer në majë të Parnasit,
Ai më shikoi një grim e më njohu
Nga dora dhe fjala e ngrohtë,
Nga shpirti dhe nga qenia ime:
- Ti më je nga pjesët e mia
Që m'i kanë përdhosur hajnat antikë -
Më tha e më pranoi në vargun e Ilijadës,
Mori frymë lehtë ai korife
Dhe në një gjuhë të Evropës,
Për një çështje sensacioni,
Citoi bindshëm: - *The eagle in air*⁵..
Buzëqeshi nga zemra e vajti të falej
Në qendrën e orakullit të Dodonës.

2.

Dikur vajtëm, të etshëm, pas gjakimit tonë
Që njëherit të shihnim me kureshtje,
Sesi ëndrrat bulojnë në El Dorado
E sesi lumi i jetës ec me brufullimë.

U futëm madje në njëri-tjetrin
Asht e palcë u bëmë me gjurmët e leshta,
U shndërruam në dashuri e përjetësi,
U shprehëm për mirëtakim e mirëqenie
Dhe me sytë filxhan u ftuam gjithkund
Në hapësirën e lashtë të këngës sonë
Të plagosur rëndë me tri shpata!

(1989)

⁵. The eagle in air - shqiponja në ajër (ang.) Kjo sintagmë gjatë shekujve të shkuar ndryshoi, duke i rënë disa shkronja që të mbetet fjala ILIR. Iliria e hershme është quajtur shqiponja në ajër, për shkak të pozitës gjeografike dhe etnike: kokën e ka pasur në Egje, kurse bishtin - në Baltik; njërin krah në Bjeshkine e tjetrin në Karpate (A.I.)

HOXHË VOKËS⁶

/Me rastin e promovimit
të librit “MENDIME”/

Në Mendimet e Tua shoh natën e detit
Me ishuj të ndarë e përndarë:
Në veshët e tyre shpërlahet një zë
Dhe në sytë e tyre, errësira e kohës,
Me heshtjen e vdekshme mbi supe,
Sikur don të buçasë me tërë detin më.

Aveniri i fisit Tënd është dëshira Jote
Ende e paplotësuar, ende e paniveluar,
Por në qiellin e tij lëvizin yjet
Që tufa-tufa të futen ngadalë në ne,
Për të na e selitur nurin në shpirt
Dhe emri Yt lavdish të rritet përmbi re.

(30 shtator 1991)

⁶ Rexhep Voka (1847-1917)

OAZA E FLIJIMEVE

Oaza e flijimeve
Me gjarprin pranë Dervish Carës,
Osman Daci e pa gjarprin
Sesi i kapërcente nën këmbë,
Ose Kelmendi i shikonte këta
Nëpër një unazë toke:
“Do ta ha gjarprin
Që ta shoh skajin e botës”.

Në oazën e flijimeve
Qe shenjtëri Osë Kelmendi,
Osman Daci qe analitik
I ngjarjeve pa gjuhë,
Kurse Dervish Cara -
Fytyrë e sprovave të rënda!

Në oazën e flijimeve
Këmbët qenë të lehta,
Mëngjesi qe ritual
I gjërave të shtrenjta.

Oaza e flijimeve
Këtë emër e fitoi nga guximi ynë,
Ky emër i mbeti nga ushtima e maleve
Sa për të planur dreqi,
Sa për të lehur qeni i çartur.

Në oazën e flijimeve
Që simbolizonte lashtësinë tonë,
Ekzistonin gjërat që binin,
Që rrëkëlleheshin,
Po edhe kënga që e lëvdonte
Osë Kelmendin e mirësisë
Dhe legjenda për të vërtetat
Që lindnin të mëdha
Nga Dervish Cara me shokë.

Oaza e flijimeve
Qe parajsë që digjej,
Qe rrugë që çonte
Nga dritat e jetës sonë
Dhe përpyekje solide
Që kurorëzohej me dafina.

Oaza e flijimeve

Ngreu padinë
Kundër gjuhëzimit të përdhunshëm
Të pamendësisë së kohës
Dhe njëherësh të çohet nga balta
Me emrin e heronjve të vet
Me të cilët do të himnonte
Përlindjen e lirisë
Dhe ngadhënjimin e Fisit
Epokave të përjetësisë.

(1987)

TRIPTIK

1.

Mbi gërmadhat e reja
Të një qyteti të lashtë,
Ku çohen të vjellat
Nga fjalët pise - nga sharjet,
Ku ëndrrat e gurta rrënohen
Si kulla prej letre
(Që nga pragu në prag)
Nga kuçedrat e çelikta
Të kohës sonë të përdhosur
Që i ndërren gishti
I dorës së përlyer me gjak,
Fëmijët lotët e nxehtë
I kullojnë mbi gërmadha
Dhe një transparent
Bartin buzagaz
Pingul me rend -
Të kësaj Toke jemi!

2.

Një klasë fëmijësh
Të fundosur
Në gjolin e pikëllimit
Në një fshat lashtor rreshtohen
Në krye të një mizërie njerëzish
Të plagosur në shpirt,
E mbi supe bartin
Tokën e Qiellin,
Në kurorat e përmortshme
Shkruajnë me gjak:
Njëmbëdhjetëvjeçari,
Afrim Prebreza,
Kufi i vuri kohës
Me shumë mocanikë martirë
Dhe hapësirën përjetësoi
Me gjakun e vet të dëlirë,
Të kësaj Toke jemi!

3.

Gjékundi sofrë nuk shtrohet
Për fëmijët e fisit tim,
Atyre u rrëmbehet

Një pjesë jete
Nga duart, nga goja
E mbase u thuhet:
“Vdisni ju, bre,
Që të rrojmë vetëm ne!”
O, të gjitha i kuptojmë,
Po si s'i kuptojmë, more!
I kemi ditur bile
Edhe kur vdiqëm me mijëra
E varret na mbetën “virana”
Pa emra,
Pa nishana,
Po megjithatë
Të kësaj Toke jemi!

(5 qershor 1991)

ME TRAP NDËR VALË

Mbaju qiell për një tokë,
Mbaju tokë për një qiell,
Mbaju popull binjak me diellin
Në këtë Breg me tufa lulëkuqesh,
Me këtë shpirt me plagë t'egra:

Hije t'ka mejtimi n'ballë
Dhe ai duf që n'zemër t'allë.

E kur besa e pajtimit
Para bjeshkëve t'fjalëve t'matura,
Të marrë flatra përmbi plagë,
Shpejt ndasia e shkatërrimit
Vdes, e lind një jetë pa skaj
Rreth e rreth me këngët n'gji

Që shërbejnë për dashuri,
Kanë erëtimën njëditëzaj!

Ajo dorë që helmon lulet
Më të bukura të gjirit tonë
S'mund t'i dojë as të vetat,
Pse s'ka zemër e as shpirt,
Jeta e saj s'e ka t'zonë -
Degë pa lis është në pronë,
Qimen e ujkut e ka fis:

Ajo i ndërrohet, po hija kurrë,
Virtytin mllëfi ia stolis!

Gjithmonë lisat me bigë n'degë
I nget rrufeja shpesh e rrallë,
Ku një mall nga nuri shkrep
E një zemër frymon n'kep,
Ku një avull del nga ëndrra
E një kandil e ndez zgjëndrra
N'guaskë këmbëngulëse t'u japë jetë
T'i mbijetojë, duke u djegur
Mbi rrugë t'madhe të njerëzisë,
Bashkë me Agun t'i ngrohin vatrat
Që e bartin malin n'kokë

Me këmbë të futura thellë në rërë,
Thellë në rërë në këtë Tokë.

Mbaju tokë për këtë kokë,
Mbaju qiell për një diell,
Mbaju popull rreth e rrotull,
Që kur linda bashkë me qiellin
Vetëm n'ëndërr e krijove diellin!
Para teje e ke detin,
Po ki kujdes me trap ndër valë: -

Një gabim një shekull s'vlim
As ia del e as ia fal!

(12 qershor 1990)

II
DUKE NDEJUR MBI
SHKËMBIN E VENDLINDJES

AMANETI

Shkëmb i dashur, po ta lë amanetin tim:
Të flasësh për mua, për zjarrin që kam
Në zemër, për ëndrrat, për shpresën,
Për diellin gri që nuk më shuhet në gji.

Poezinë e kam ninëz, të mos ma lëndosh,
Shpirti im është zog që cicëron në të.
Te ti e nisa fjalën dhe këngën e parë,
Erdha t'i them mbase edhe të fundit.

Besomë, nuk kam ndryshuar as me ëndrra,
As me vizion. Në vargun tim ka pranverë
Në vazhdime. Shtatë zemra regëtinë në të
Për jetën, për këngën, për poezinë e re.

POEMA E PANIT

Lisa, lisa, lisa - lisanjë. Një koloni lisash
I ngroh afrimi, i ftoh largimi, nguliten.
Njëri-tjetrit krahun ia kanë hedhur mbi supe
Dhe përgjojnë pëshpëritjen e plymit cicërues.

Lisa dhe qiell. Qetësia pëllet. Puhia lozonjare
I vë në lëvizje gjethet deri në harrim.
Ndodhin çudira, kumborëzim, ëndrra shumë:
Thuret poema më e çuditshme në botën e Panit.

Në mbrëmje enigmë, në natë rebus, në agsholl
Merr fund zgjidhja e tyre te Kroi i Sulës.
Secili nga lisat ka trofe qafore inxhish.
Rrezet thyhen në pika vese. Spektër ylberash.

FYELLI

Këtu kaloi një çun syrrush dhe ma dha
Fyellin e Panit, për t'ia falur rapsodit.
Askush nuk kaloi me diell në gjuhë,
Më mbeti porosia të plaket në mua.

Ai fyell çudirash kujtimet m'i përpushi
Pupagjel në zjarr ndjenjash trazuar.
Pas Gjergj Elez Alisë i rashë fyellit,
Malet e ndërruan pozitën. E rapsodi

Mori porosinë e vet. Mbi shkëmbin tim
Vëreja fshehtësitë që s'i pa ajo ditë:
Shfletova fletoren e imagjinatës sime
Me të dhënat e përditshmërisë lësh.

ËNDRRA E SHITUR

Kur s'i vjen uji burimit, shtatë male
Dalin në procesion, për ta lutur shiun
Me kukull. Dita strupull fut kokën thellë
Në shuplaka e shuplakat kanë formën

E varrit, për çastin e ikur nga vetja.
Ai që e di se ku e ka fshehtësinë gjuha
E zjarrit të ferrit, e marrin shishe
E venë mbi mur! Kukulla e shiut bën roje,

Retë në çetë e lajnë me fontana zjarri.
Kërpudhat dalin të venë në dafrung.
Shfrenimi arrin kulmin e tradhtisë,
Kënga nuk është më, shitet ëndrra. Zi.

KUSH THA

Kush tha se rrufeja flijohet vetë
Për bimësinë e tharë të fushës?
E megjithatë - ja, po digjet fusha!
Rrufeja nuk e sjell shiun, shiu

E sjell rrufenë, për ta therur
Renë e zezë me thika të mprehta
Zjarri. Hip në kupë të qiellit,
Rreh gjoks për bimësinë dhe tinëz

Krihet me krehër të rinj prej ari.
Ezopit i ngjesin bishta të rinj
Dhe një palë brirë të mprehtë,
Lulja e shpatës qeshë mbi mur!

LOJA MBI THURIMË

Dy gjela në një thurimë këndojnë
E kënga e njërit digjet flakë.
Përrallën e Cung Lapushës së ri
S'e paskit ditur se është shyt

Me tri kokë majë plehu në lëmë!
Thurima ia bart këngën gjelit
Që nëpër kurt shëtiti gjithandej,
Fijet e kashtës ia zënë këmbët.

Kënga e djegur këndon më bukur
Nga hiri i vet, kënga e thurimës
Këputet në bel nga dëshpërimi
Dhe thurima e frikësuar dridhet.

LLAHTARIA

Krokodili e mirësia përqafohen:
Krokodili qan e mirësia preket.
Në ekstazë të thellë krokodili
Mirësinë e gëlltit nga dashuria.

Ëndrra e përrallës është ferra,
Përralla është historia e ferrës,
Që në gji ruan një lule gri
Dhe një gjarpër të larmë nën gur.

Ferra e ruan në gji përrallën,
Gjarpri nën gur ruan lulen gri,
Dashuria e rrejshme gëlltit urtinë,
Gabimi nuk vjen dy herë në derë.

QËNDRESA

Qëndresa përflaket qiri rrugëkryqeve
Të fatit, end pëlhurëza të bardha
Me fije ardhmërie. Ajo nuk është gur
Për ta vënë në mur, digjet deri në hi,

Prej hirit buron nur. Është shteg
Pritjesh për një mrekulli, viadukt
Ylberor në një dashuri. Nuk vdes,
I vdesin ëndrrat; natën e therr berr

Për një Dëshirë mbi të gjitha tjerat.
Dy herë s'është si shihet një herë,
Në shet realitetin për synim të ri,
Ka shtatë fshehtësi për simbolin e vet.

BESA

Këndit të lavdisë ec mashtrimi;
Këndit të mashtrimit udhëheq
Floriri. Mandej në hijen e vet
Mbështetet syçelësia. Argusi lind

Për së dyti në yjësine e bërthamave
Të plota. U tha se u tha: engjëjt
Besojnë aq shumë që të pësojnë
Në mosbesim. Qeni besnik frikësohet

Nga pitekantropi, të mos e kafshojë:
Mbetet invalid për tërë jetën.
Një palë bigëza (për këmbë e duar)
Kushtojnë një shekull e fjiu...

ENA E BRISHTË

Guri ka zjarr dhe në zjarr pëlçet;
Zemra ka zjarr dhe zjarrin ndërpret.
Zjarri e guri u mpinë, cili seku
Të vete. Detin e ka shtruar stuhia,

Stuhinë guaska e mbyll në kuti magjie
Në fund të detit. Zjarrit të madh
Të dallgës brigjet i përballojnë
Me akull nemitjesh. Tërheqja e saj

Hënësinës do të bëhet me stërkala
Dhe do ta gjejë të thyer enën e vet
Të brishtë. Nën lis me plis kavallët
Bisedojnë për famfaret në horizont.

NDRYSHIME

Nipi i Cen Lulit, me engjëll në gjuhë,
Pinjoll Lulin e merr nënsqetull dhe fjiu
E shëtit në kohë. Në barkun e fjalës bart
Fetusin e ardhmërisë. Në zemër dashurinë.

Në shpirt i rrotullohet një gur i rëndë
Bregdash me bajrak. Në dy pika lot në faqe
I shihen dy botë: e gjyshit dhe e babait,
e vetja e çelë në një lule, që ëndërron

Dorën e atdheut në ballë të vet dhe lumin
Nëpër të cilin shikohet qielli. Anija e re
Lumore ka emër. Në të udhëtojnë yjet
Që nga njëri në tjetrin skaj të atdheut.

DHEMBSHURIA

Veshur e ngjeshur me pancir ari macja
E kashtës, me ferra në gjuhën shpatë
E shpata se pret. N'intervale kashta
Përjashta: me hënë tjetër në zemër,

Me diell tjetër në ushulla. Hëna e vet
Dridhet në natë, dielli i vet se ka
Krahun e djathtë. Klluka e kashtës kokoriz,
Nuk çanë kokë për pancir të shtrenjtë.

Kashta nga jashtë vjen me rrugë në sy
E me eshtra në trastë. As qeni, as gjeli
Hijen s'ia matin. Dy zgavra në lis
Shikojnë në thellësi të kohës së vajtur.

MËKATI

Lis Bardhi paguan dy herë: një herë
Për të vërtetën, të dytën për kotësinë.
E vërteta ia sjell atë që e detyron,
Kotësia paguan pamundësinë e tij.

Dëshirat i ka mikroplanetë; nuk ka hundë;
Gjithë çka ka, ka vetëm në këmbë.
Shpresa e tij është botë fare e errët,
Këtë e di instinktivisht. Rrëshqet prapshtë

E shikon para. Në rrugën e tij gaforja
Se çmon bërthamën e plotë, po xhepin.
Bën rrugë tepër të gjatë deri te hiri
E zjarri hijen s'ia djeg për levërdi.

PRUSH NËN KËMBË

Klluka dhe zogëzat e përkëdhelura plot naze;
Gjeli ua shton puplat, ua stolis, i sqimos.
I duan zogëzat e veta. U japin hapësirë pa fund
Dhe ëndrra xhepi burim. Hingëllojnë mëzat

Të mos u dalë kush para. Shtatë kodra i rropin
Me uturimë. Gjeli e klluka fryhen rrëshiq.
Kur e arrinë kulmin e vet, ua nxjerrin sytë
Zogëzat me shkëlqim. Verbërimi lind e rritë

Të verbër. Dashuria që prodhon ulokë në kohë,
Virtytin e çakërisë dhe sytë e tij vrasin
Me brirët e dashurisë së pamatur në dashuri.
Qelizës atomet i dhurojnë prush nën këmbë.

LAMTUMIRË

Pëllumbi e vida në shtat me florë e gurë:
Pëllumbi se di, vida se di. Heroina skulptor
Me daltë e majth ua grimcon ngadalë gurin,
Shohin ëndrra se janë princ e princeshë.

Dëshira s'është e tyre në fillim të rrugës
Me ferra. Gjaku i tyre i tradhton me porosi!
Dhëlpres s'i duket bishti. Parajsa kundër
Lëmsh e lëmsh i mbështjell në ferrin e vet.

I çelin sytë, shohin se janë torzo nazike
Në ambient të bardhë me gjuhë të shkurtuar
Për fjalë ngushëllimi. Dy lumenj rrjedhin
E fusha thahet. Stinë e florës, lamtumirë!

NË GJURMË PAS ORFEUT

Orfeu ka ikur gjëkund në mal, në fushë,
Te ndonjë rrip toke, për t'i mahnitur zogjtë.
Zëri i tij s'është këtupari. Është ulëritja
e luanëve bredhës. Garritja në dritarezë,

Në podiume. Orfeut ia kam dhënë veshët e mi
Të m'i ruajë nga rrokullima, nga ëndrra e saj.
Zëri që më rriste s'është më, m'i ruante
Veshët nga shurdhimi, që më detyron ta kërkoj

Orfeun. Kini kujdes nga Orfeu i rrejshëm. Fryn
Era në ambientin e tij të rrejshëm. Shkulet
E ngulet lisi i tij. Marramendje. Të vjellat
Na e përkujtojnë se nuk jemi më ata që jemi!

SHENJAT E MISTERSHME

Në kohë thatësire uji kthen te burimi vet
Që të vdesë. Unë ia ktheva vendlindjes një ditë
T'ia lëmoj fjalët që në vesh ia thashë dikur
Mbi të njëjtin shkëmb në të njëjtin kuvend.

Natyre e njëjtë me pak njerëz të njohur për mua.
Disa ose s'janë, ose në natyrën e sendeve galucë
Janë bërë sende të palëvizshme. Dikush fjiu
Është përplasur në panjohësi të errët të botës.

Qeshë dhe pashë. Disa herë u nemita. Pikëllimi
M'i bëri strehë lotit. Jetën e mata me një pé,
I cili ka skaje. Në skajin e fundit jam unë
Me vjeshtë në gjuhë, me pranverë në zemër.

VAZHDIMËSIA

Pranë fjalëve tona do të ulen fjalët e ardhme
Me tehun brisk. Biseda do të përflakët gjatë,
Do të ketë mirënjohje për fjalët e vjetra
Prijetare. Fjalët e holla do të futen në gjuhë

Të ngathët, për ta shkathur deri në infinit.
Ezopi do të mbetet pa fjalë në atë rreth mitik
Dhe Gëte do ta përcjellë lotin të mos i shihet
Në mes të të avancuarve. Prej një burimi të ri

Do të pinë ujë të gjithë, po niveli do të jetë
I etjes, që shuhet me finesën e autentitetit.
Dhe fjalë pas fjale do të krijohet piramida
Me sfingë. Ëndrës ngadalë i vjen gjaku në buzë.

PËRKUSHTIMI

Ti brengë më e keqe se brenga që ngërçit, shtang
Në hirin e këngës. Sharjet mbillen, rriten
Duke futur rrënjë në veshë. Kohë meskine
Me gojë të çara meskinësh, ujqër nëpër trarë.

Gjakun nuk ua fali për ëndrrat tuaja me duar
Mbi zjarrin e trupit tim. Bliri im i molltë
Ka nxjerrë filiza të rinj. Të qartë e kanë rrugën
Edhe pa ju. Yjësisë i rriten kuajt e Pegazit.

Buzët i lëpini e keni mbetur pa gishtërinj
Në dorën e fatit tuaj. Fat i thënshtin errësirës
Që ua shndrit rrugën e verbër! Kujtimi im
E ka mëngjesin e vet, i juaji këmbët a i ka?

ZBULIMI

Një vogëlush me një plakush majë gjuhe
Marshon. Një plakush me vogëlush në botën
E ëndrrave të tij. Tërë ditën e shëtitën
Prej agimit deri në muzg. Vogëlushi tha:

Mua s'më njeh kush, se ende s'kam lindur
Për këtë kohë. Plakushi atij vogëlushi
Në ëndrra të veta dëshiron t'i bëhet nun;
Një botë e re mugullon nga sytë e Argusit.

Vogëlushi qesh nën mustakun që s'e ka,
Shndërrohet në cicërimë të një zogu gri
Që Lisnaja ende s'e ka parë. Do ta njohë
Vetëm kur do të vijë, për kuptimin e saj!

DASHURI ME MËRI

Aq e dua këtë cicërues sa aq shumë e kam mëri,

- I tha njëri zog zogut tjetër në degë bliri.

I dyti iu ngërmua: Po përse në zemrën tënde
Gjithë ajo dashuri ka shndërruar në aq mëri?

- I vetmi motiv, bre, është pse ai cicëron,
E kam inat, haj ta vrasim, s'mund ta shoh!

- Tjetri me pikëllim të tretin e salutoi
e zogut të dytë i tha: Ti na qenke i marrë!

- U grindën zogjtë e blirit për zogun e tretë
Që në rrugë të vet fluturonte qetë e qetë,
Pa i bërë keq askujt. Cicërima e tij jehoi
Deri në fund, po fjala plagë i mbeti përjetë.

LULET DHE ERA

Duart e erës ledhatojnë lulet në luadh,
Shkëmbi më nis për te ndjenjat e mia
Të lodhura nga ledhatimi. Fjala e ndal erën
Dhe duart e saj më lëvaren urth në qafë.

Nuk e di: hidhërimi i erës më ngulçon,
A ikja e ditës? Shkëmbi më mba me vete
Të ngujuar, më thotë t'i bëj shoqëri,
Shkëmb të bëhem pranë tij në përjetësi.

Ia jap zemrën time dhe ëndrrën e shpresës,
Që të më lërë të qetë ta vazhdoj rrugën.
Fitoj një zemër tjetër nga sytë e nipit
Dhe nga këngët e mbesës, plot limonti.

(Gajre, 15, 28 gusht 1993)

TRIPTIK

(SHKRETËTIRË)

Rërë, rërë e përsëri rërë. Det i madh rërë
Pa asnjë oazë, pa asnjë zog, pa asnjë gazelë.
Në vallëzim me rrezet e diellit të kallur
Nga agu në muzg. Nata numëron yjet që vdesin.

Çdo kokërr rërë është busullë e pavulosur
Në detin verbues të shkretëtirës pa cak.
Nën rërë - pafundësia, mbi rërë - qielli gri,
Rëra në mes dy zjarresh nuk digjet me flakë.

Zogu e gazela krijojnë oazën e çuditshme
Të mirazhit ku, që nga burimi në burim tjetër,
Ylberi krijon imazhin e peizazhit të passhiut,
Shenjë se mund të jetohej edhe me iluzione.

(VAZHDË NË DETIN E RËRËS)

Nëpër detin e rërës një vazhdë e proshtët
Dhe anembanë saj gjurmë pa emër e pa jetë.
Hijet e paidentifikuara kanë tërhequr zhag
Trupin e ëndrrës, që mbijetohet durueshëm

Në saje të qëndresës. Hijet amorfe e viktima
I ndërrojnë rolet e tyre. I mbijetuari
Tërheq pas vetes një numër të madh hijesh
Ëndrra, nga mundimi shndërrohet në martir.

Kështu ndodh, kur ndërrohen rolet fataliste
Dhe hija hijes tjetër i bëhet viktimë. Liria
Në mes tyre mbetet me rolin e vet fiktiv.
Jeta në ëndrrën e viktimës është mirazh gri.

(OAZA)

Palmat dridhen n'ujë e në to cicërojnë zogjtë.
Që nga njëra degë në tjetrën shihet pezhishka.
Me ëndrrën e zogut vjen edhe ëndrra e zezë
E merimangës. Krokodili zhagas e tërheq për gjuhe

Gjahun e gjahu i bëhet shkop midis nofullash.
Sytë e zmadhuar të krokodilit që nga fundi
I lumit ndjellin fundin e ditës së fundit,
Imazhi i breshkës së ujit krenar del mbi ujë.

Bimët kanë ardhur me ujin e uji me shpresën
E udhëtarit të lodhur. Oaza i bëhet shtëpi.
Pema e pjekur i bëhet urë e burimi i jep shpirt
Të mos e ndjej veten zë i humbur në shkretëtirë.

(17 tetor 1993)

VDEKJA E MITUR

E lidha gojën fortë. Hundën e lashë të lirë,
I mbylla sytë me shami, për t'u paluar kapakët;
I drejtova këmbët e duart në pozitë të drejtë
Që kufoma të marrë formë e hije për tabut.

Prita çastin i qetë, po kur më vajti mendja
Te veprat e pakryera, që s'i kisha në rregull,
U çova të jetoj me librat, sipas radhës që kanë
Dhe në fletore t'i lë disa vargje prekëse:

Punova shumë, o njerëzit e mi, po jetova pak.
Të vdes nuk kam kohë të mjaftueshme. E lus kohën
Të vijë e të jetojë për mua. Erdha në vete,
Dola nga shtëpia me vdekjen e mitur përdore!
(23 tetor 1993)

III PËSHPËRITJE

LËVIZJE

Aty ku ishe dikur më nuk je,
Ku të kërkuan më s'të gjetën,
S'do të mund të të gjejnë ku je tash,
As ku mund të jeshë nesër.
Koha s'është ide që pushtohet
Kur të lëvizësh n'kohë e n'hapësirë
As vendi e as koha s'është më
Me emrin e vet t'vërtetë.
Vendi nuk të ka mbajtur njësoj,
Siç të ka pasur njësoj.
Koha nuk të ka gjetur si je,
As që të ka marrë si je.
Poshtë e lart kanë një kuptim,
Që kanë bërthamë rëniengritjen.
Rrezen e diellit e ka n'kujtesë
Edhe nata e lodhur nga vetvetja!

(19 dhjetor 1990)

NJËSHMËRIA

Me gjymtyrët që ka dikush të njuhë,
Me ato edhe të pranon siç je
Me të përngjarë të njëjtë,
Duke të krahasuar me vetveten:
Bashkë keni dëgjuar këngën e zogut,
Bashkë keni ndjerë lëvizjen e barit,
Bashkë keni parë si çelin burbuqet,
Bashkë keni parë lumin si vet amës
Duke rrjedhur në pafundësi të kohës
Nëpër damarët e hapësirës.
Por ama - ai s'di se çështë
Zogu këngëtar i vetëdijësimit,
Ai s'di se njëshmëria s'njësohet me kuptimin
Nëpër lumin e amshuar të jetës
Më ndryshe të kuptohen sendet
Edhe shumë kohë pas kohës që frymon.

(19 dhjetor 1990)

KORNIZA E LËVIZSHME

Nëse dëshiron t'i thotë diçka jetës, le t'i thotë
Por le të presë kohën sa më të përshtatshme
Që të gjendet në trekëndësh me të
E koha të shndërrohet në eng,
Për fjalën e tij që kuptohet lehtë.
Mendoj le të presë pak derisa të lëvizë jeta,
Atëherë që të gjithë do të jemi një
Edhe me gjymtyrë, edhe me kuptim,
Edhe me burimin e imagjinatës së bujshme.
Koha do të pushojë të jetë eng,
Por ajo do të jetë e njënjëshme me jetën
Dhe do t'i shpërthejë katetet e trekëndëshit
Për ta krijuar kornizën e lëvizshme
Që të zgjerohet deri në pambarim
Të dëshirave, që s'do ta tradhtojnë kohën.

(21 gusht 1991)

VAZHDIMI I VETVETES

Trim është ai, që me tehun e fjalës
Me saktësi pret tehun e shpatës,
Por edhe ai që heq dorë përgjithmonë
Nga kënaqësitë, që nuk sjellin lumturi.
Do të habitesh mbase aq shumë,
Kur e paprekshmja do të prekë ëmbël
Duke dalë nga çapi yt me kohën në dorë.
Toka, zjarri, uji e ajri lëvizin,
Vetëm koha nuk lëviz në mënyrë anakronike,
Lëviz vetëm kuptimi për kohën,
Koha stimulon dhe matë lëvizjen.
Nëse mbetesh pas shpinës së kohës,
Hapërimi yt s'i takon amshueshëm
As tokës, as zjarrit, as ujit, as ajrit,
Jashtë tyre nuk mund të të njohin.
Nëse heqish dorë nga mijëra dëshira,
Që s'u përshtaten vuajtjeve për kënaqësi,
Do të jesh në kohë ana e pestë e botës
Dhe vazhdimi i përjetshëm i vetvetes
Në ballancë të saktë të kohës.

(21 gusht 1991)

BINDJE

Vetëm dita ditën e pushton,
Kur njëra hyn e plotë në tjetrën.
Nata e gjatë - nga dita e plogësht,
S'ka natë kur s'të mjafton dita.
Kalit të ditës ia vunë ngosën
Të kuptohet si të venë punët
Rreth dëshirës që merr flakë,
Rreth vullnetit që zhvendos kodrën
E u jep krah pëllumbave në qiell.
Te okullisti i zhvendosën sytë
Për ta bindur kohën e vet
Se uji mundet të vete edhe përpjetë
Po s'kuptojnë se kthimi i tij
I bart lëmishte të pavlershme.

(20 dhjetor 1990)

PËSHPËRITJA

Pemët e veta të buta i shartuan me të egra,
Zemrën e vogël e bënë ende më të vogël,
Që në skenë të dalë iritimi nga maska demode:
Spektatorët e krisur të qeshin me aklamacione,
Në këmbë të çohet mashtrimi,
Të mos shihet se çka fshihet,
Të ndjehet se çka s'ndjehet,
Ëndrra të mos bëhet zgjëndërr,
Dënimi të merret për shpërblim!
Dhe nemitja arrin të identifikohet me ironinë,
Kur heshtja bëhet pëshpëritje e zëshme
Përtej vetvetes dhe pakohësisë
Në kohën që kapet për tejkohësinë.

(20 dhjetor 1990)

PLYMI

Nështrat i lashtë frymorësh të zgjuar
Me gjurmë të qarta të mbitokës e nëntokës,
Me rrënjë të lidhura për shkëmbin e vatanit.
Të përbuzur, si një plym zogjësh mbahen
Në fërtymë të akullt dhe në stuhi,
Duke u kapur edhe për barërash në vërri.
Cicërima e tyre e zgjon Tokën,
E mendon Vardari se peshqit ëndërrojnë,
Se po bisedojnë edhe ëndrrat e zogjve
Mendojnë drunjtë, që i tund era në breg.
Metafizika e boshatisur është e nemitur:
Për fjalë fisnike, bujare,
E flitet me paramendim mekanik,
Me paramendim paranoid të zhveshur.
Plymi i zogjve tash kapet për drunjsh
Që vuajnë pse firon ëndrra e Bukuria!

(19 dhjetor 1990)

KRROKATJE

Vrugut shkrumues cipa i grisit fare
E i duket zemra, shpirti, gjuha,
E këmbët i zënë në këmbët e pemëve të buta
E i mendon pa fantazi,
E i mendon për shut e top shutimi.
E blirët s'i vëren marrëzia
Me atë erëtimë të fisnikëruar,
Ajo do kundërmim bërrakash e rrillash.
Nëpër blirë këndojnë zogjtë këngëtarë
E sorra në plep krrokatë deri në kupë:
- Vdekje-o, kërra, kërra, kërra...!
- Zëri i grathët i saj shpirtin grith,
Peizazhi ngjethet,
Hëna e fut nën sjetull e hesht.
Dehja tash kërkon shi
Nëpër fytyrat e pafajshme me vrragë
Dhe vetë mbetet pa busollë të saktë:
Në fjalë, në mendime, në ide.
Dhe rretoset duke dëshmuar veten
Para qiellit e kohës...
Me furtunë i përdhos drunjtë,
Që kanë mundur ta mbijetojnë veten
Edhe gjatë Epokës së Akullit,
Edhe gjatë Epokës së Thatësirës.

(19 dhjetor 1990)

ZIRË NJËSHMËRIE

Nga puplat e drurit
I njëjti gjeth përsëritet
Me të njëjtën erë,
Me të njëjtën ngjyrë e zirë,
Me të njëjtën bukuri dhe shëmti,
Me të njëjtën vuajtje dhe lumturi.
Asgjë s'është e njëjtë
Pa njëshmërinë e vet;
Ndryshimi kryhet
Brenda ndryshimit të vet,
Për të mbetur i njëjtë
Me rrënjën që s'i ndërron.
Me fanatizëm e ruan qenësinë
Dhe harrohet në identitet
Të jetë veçse çka është vetë:
Edhe prej hirit veten e zgjon.
Gjithçka ndodh në lëvizje
Në marrëveshje me levërdinë.
Qenësia mbetet e njëjtë,
Pa të njëjtët,
Me ëndrrat
E dashurinë.

(19 dhjetor 1990)

HIJE

Këndija është dritë dhe errësi,
Është zjarr dhe akull;
Krah lareshe dhe krah ere;
Jetë para hapësit dhe pas hapësit;
Ajër që ngulçon dhe freskon.
Është çap prapa dhe para,
Është ujë amull dhe krua,
Është lindje dhe perëndim.
Nëpër gjak e ka ngecjen dhe shtegun;
Nëpër zemër dashurinë dhe urrejtjen;
Nëpër tru gjurmën dhe përkufizimin;
Nëpër jetë uratën dhe mallkimin.
Herë rrëkëllehet e herë fluturon;
Herë grith e herë ledhaton.
Për dikë perëndon, harrohet;
Për dikë lind, amshohet.
Kur e njih të përflak, të përgjak;
Kur s'e njih s'të bën konak.
Këndja është hije,
E vërteta për të është e hidhur,
Ose pishë e ndezur prishmërie.

(4 dhjetor 1990)

NGURROSJE

Thamë që të mos lëvizë asgjë
E nëse është e mundur
Të ngurroset deri në pamundësi.
Thanë e s'lanë gjë pa thënë
Për moslëvizjen, për ngurrosjen
Që të mos i hapen dyert ditës:
Dielli të prangohet në përrallë,
Koha të stoliset me plagë,
Gentiana të mos kultivohet,
Yjet të dridhen nga drita e dobët,
Gjaku të mos ketë rrugë kalese,
Toka të çahet nga thatësira,
Syri i shpresës të vyshket.

O tempora, o mores!

(20 dhjetor 1990)

MARRËZIA

Marrëzia ik çartaqefas
Pas hijes së hiles së vet
E nëpër peizazhin e molltë¹
Lë marrosjen e fytyrës shkollë,
E cila i grish rrugët
E mbarsura me heshtje
Të mbushen me hapat e ligë të jetës.
Por shtegu shtegut të marrëzive
I qaset me qesëndi:
- Plepat që ndjellin erë,
Nga era do të shkulen,

(19 dhjetor 1990)

¹ E molltë - e verdhë.

IV
KOHA QË S'MATET ME
VUAJTJE ËSHTË THJESHTËSI

RELATIVE

Me shenjat e huaja s'do të përgjigjemi
Kemi respekt e denjësi
Ndaj kohës dhe ndaj njerëzores.

Rruga derdhet në shpirt me tëra rrugicat
E pamatësisë i përgjigjet paanësia
Me përmasat e kohës së pamatur.
E kërkosh atë që zhduket në përrallë
E gjesh në përditshmëri të hakëruar.

Apasionata të ngushëllon me yjet e gjithësisë
Në të kundërtën e fatamorganës,
Që i pathyeshmi të mos jetë inert.

Gjithësi nuk ka kur nuk ka kohë,
E gjithësia është që të jetë koha,
Koha që s'matet me vuajtje është thjeshtësi.

Çastet kur rrënkohen nga barra e jetës,
Koha ndërron gjatësinë, bëhet relative.

(shtator, 1990)

EMBRIONI

Vuajtjes me fjalë s'mund t'i besojmë,
I besojmë gurit me kultere n'rugë
Dhe blerimit, që mbi të plandet vesa.

Në ne ka akull, zjarr, prush e hi:
Mund t'i qepim në jelek sumbulla
Të të pesë kontinentet
E pjellorisë së fjalës vigjëluese.

Në kontinentin e gjashtë të mendimit,
Mu në shqisën e gjashtë,
Futemi fshehurazi ta asgjësojmë
Dileriumin e kohës së fjetur.

Meqë s'përpiqesh aspak t'ia ulësh vlerën
E ta zvogëlosh hijen e të vërtetës,
Vdesish të lindësh për të jetuar!

Skepska e mjegullon magjinë e ëndrrës,
Besimi i përlind dëshirat në rritë.

Embrioni është rrënjë që nuk tretet,
Është jetë që e lanë fytyrën me dritë.

(shtator, 1990)

MANIRE

Do të ketë boshllëqe fjalësh
Që dinë të llomotitin
Nëpër mendimet, që thyhen si qelqi,
Kur koha kalon me të gjitha rekuizitat
Me të cilat krenohet.

Hija djeg prush, zjarri mardh akull,
Analogji që pëshpërisin
Në veshin e bindshmërisë,
E cila i ka shpërngulur sytë
Në lulishten, që vjen nëpër hi.

Atje fshihet një emër i stolisur
Me kordele të mollta,
Me atë emër e kanë emërtuar
Fillimin e një dite të zemrës.

Cullak ka mbetur shëmtia
Me maniret e veta jeshil.

Tash asgjë nuk flet duke u mbuluar
Me hirin e fjalës, që djersitet.

Druri i ka mësuar përmendësh
Këngët e zogjve të zellshëm
E zogjtë dëshirat e drurit
I radhisin në diademë vizionesh.

Ninëza lakmuese e zotëron yllin skofiar
Që e gllabëron me dritë nuri
Bukurinë e mendimit koshient.
Dhe hekurin e manireve të ulëta
E shkrin zjarri i prestigjit njerëzor.

(shtator, 1990)

PËRROI HAKËRRUES

Valët e detit imagjinar thuren,
Në rrjetë e futin peshkaqenin e zemërimit,
Që si nga stina, si nga klima,
Qenë ndërsyer drejt yllit të dritës.

Çuditërisht çudirat çuditen,
Marrëzirat marrëzohen. Trajtë piramide
Ka kujtesa, kur rrënkon mosgjëja
Që s'mund t'i marrë krahët,
Për t'u çuar më lartë
Deri te kërthiza e pamundësisë.

Përroi hakërrues vërshon i sëmurë,
Bart: gjak, qelb, trezorë...
Rëra kullohet. Sytë shikojnë vëngër
Anën tjetër të shpirtit,
Që zemra të digjet shkrumb
Në zjarrin e akullit të frikës.

Porse, çdo gjë e dënuar rreptë
Nga sendet e dënuara dridhet.
Hidhërimi misterioz shprehet
Me shenja të llahtarshme në mur.

Vetëm i vuajturi i ka sytë teh thike
Dhe kuptimi i tij gjerësitë eruditive
Për të vërejturit, që pikas devotshëm.
Lëvizjet vendit të lodhur nga intenca
Që sendet të mos e kopjojnë
Cilësinë e fatit të ndërsjellë,
Fatit, që s'e kanë të njohur.

(shtator, 1990)

ZHURMË LLOKOÇITËSE

Në kujtesën tonë ka një det llokoçitjesh
të përbërë nga valët e kujtimeve,
Në të e ndjej shllapuritjen zhurmuese
Të remave të galerës së prapshtive;
Në galerë përdhosen hijet e natës pa ispat.
Nëpër çdo qelizë të valëve halucinative
Fshihet një aksion djallëzor
Të cilin s'mund ta shërojë kobalti,
Por koha kur s'e humb peshën e kuptimin,
Që s'varet nga rasti, po nga ideja.
Shpërthimi madhor i një brerimi të dritës
U merr erë shekujve vetëm në një ditë
E çastet shndërrohen në zogj të frikësojnë.
Dhe përtërihet planeti i vjetër,
E një planet i ri sillet i krisur:
Pa zemër e shpirt ia shtrydh hënëzat,
Ia rrah me shufra vringëlluese hekuri,
Marrëzinë e zbraz në një poç të bottë
Të cilin e çon Hyu, që sytë i ka në shpinë
E i përzien mendimet, për t'i bërë kolazh
Në një letër, që i duron deri te zjarri!

(shtator, 1990)

SHEKULLI PARAK

Shkrepat bëhen të nëpërdukshëm, qelqor,
Nga kujdesi që tregojnë për largpamësi.
E një grua i lanë retë me buzëqeshjen e vet
Dhe plepat i ngatërrojnë hijet e veta.
Metali rrudhet nga shikimet,
Shkrihet nga durimi
Dhe i zjarrtë zbrazet në gojë të trusnisë,
Çorroditen sendet në rrethin artificial,
Mu aty ku ia ndejnë erën e fëshfëritjen
Bishtit të shekullit të vet
Që parak ka mbetur nëpër degë.
Hënëza e gjysmës së parë të muajit,
Me hënëzën e gjysmës së dytë të tij,
I lajnë ndotësitë e të vjellave
Të një fjalori të ditës, me zhargone vesvesesh,
Dhe bëhen hënë e plotë.
Vendosmëria është ajër, ozon, ëndërr diellore
Që depërton nëpër qëllimin e pakuptim
Që i ngathët fryhet balon
Nga i cili është drejtuar sqepi i dallëndyshes.
Prej hirit krijohet zemra, edhe unë, edhe ti;
Buthtohet zogu të cilit buzëqeshja i qe harruar.

(shtator, 1990)

NË KUJTIM TË ATYRE QË NA DESHËN

Ku janë ata që na i prekën zemrat,
Që na e përflakën shpirtin nga mallëngjimi?
Shteret ndonjëherë gejzeri i syve,
Apo edhe gjatë do të gufojë nga shpirti
Me të njëjtën valë, me të njëjtën dhimbë?
Sytë e tyre bëjnë dritë në një ditë të këputur,
Në një çast shndërruar në luledielli
Kur toka në lebetitje u plasi nën këmbë.
Ortekët i mbuluan çastet e heshtjes
Më të rëndë se zhvendosja e diellit në qiell.
Prehja është ngulçitëse. Mali ronitet
I tëri në fytin spiralë të honit të detit,
Duke dashur të përplasat mbi trupin e tij
Dhe mbi anijen gllabëruar nga valët e thikta.
Nëpër dafina mbeten valët e ajrit
Si përgjigje të pazëvendësueshme të kohës
Që s'di të preket, që s'di të mbruhet.
Kuarci ia puth venën zogut të natës
Dhe gjaku i zi i jep ngjyrë mbarë detit.
Deri te mëngjesi dielli është bandil bohem
Veshur e mbathur me leckat e kaçorreve.
Vete t'i ulë majat e maleve deri në rrëzë,
Vete t'i ngrehë urat e takimeve mallëngjyese,
Që ta shfuqizojë brengën e ngathët
E ta çlirojë rrugën brerore të ëndrrës,
Rrugën, që ka kalesë të sheshtë nga rrëmeti!

(shtator, 1990)

KAÇORRJA

Jashtë gurgullon përroi
Dhe gjethet fëshfëritin n'erë,
Duke shpërndarë dehjen
E kërratjes së natës.

Ku shfaqet thatësira,
Me të çarat që thërrasin,
Vera frymon në kaktus.

Qetësia pret tehun e shpatës
Në humnerë, ku lëviz ngulmuesi
Të gjejë shtegun enigmatik.

Kujtimi bën rrathë koncentrikë,
Të vërejturit futet nëpër to.

Përjetësia e padukshmërisë
Përpiqet të bëhet e nëpërdukshme
Me përqëndrimin e ninëzave
Nëpër rrethin asimetric
Të hijeve, që ngadalë zbehen.

Kurmi i rrënimit përplaset
Në murin e kaçorres,
Duke dashur të rrëmbejë
Dashurinë e madhe ndaj pronës.

Në shpirt krijohen trusnitë,
Befasia i bën vend ngashërimit.

Nën dush të gejzerit të qenies
Lahen gjymtyrët e kapitura
Që rrojnë me qëndresë urtake,
Për t'ia hapur shtegun diellit,
Për t'i dhënë krah lulëzimit.

(shtator, 1990)

PËRJETËSIA

E ke çuar në këmbë kërshërinë perceptuese,
Ndjell sytë e rrugës që nga largësia,
Duke bartur ditën nëpër këtë lëndinë.
Me lotët e fëmijës krijon malbrez,
Këtë s'e vërejnë kalimtarët e rastit.
Përqafosh jetën e jeta ty,
Ndërsjelltas i merrni ëndrrat,
Në ballë e puthni qiellin
T'ua sjellë të përjetshëm diellin!
Ti lule e luleve që nga lashtësia,
Dhe lule e bartur nga ardhmëria,
Në botën tënde futet syri që të sheh
Dhe me feksin e nurit tënd dëlirësia
Tehun e dëshirave të topitura e mpreh.
Thellë në rrënjën ruan erëtimën
Dhe bukurinë, që n'shpiet e n'zemër s'e ka
Asnjë zili e rretosur në pritë.
Ruaje rrënjën të mos bdaret,
Të mos e kalb bërraka - nga je përnda'!

(shtator, 1990)

V
KAFSHATA E DHEMBJES

VASHAT I KËNDOJNË DASHURISË

Para dritares së vogël nënat digjen qirinj
Dhe currili i lotit u bie valë në mjekër.
Fjala e ëmbël premtuese zbut e përkëdhel,
E kur premtimin këndell, çel pranvera
Në buzë, në zemër, në shpirt, në shpresë.
Shtatë mijë mjellma zbresin buzë liqenit:
Shndërrohen në vasha e i këndojnë dashurisë
Dhe vallen rreth e rreth liqenit e zgjatin,
Krijohet një lule gjigante e Bukurisë -
Një luledielli që amplitudën diellore ndjek.
Liqeni është i lashtë e i thellë n'mendime,
Notarët në të janë të zhdërvjelltë.
Në mes të liqenit çohet diellor lapidari
Me shkronjat e zemrës: nga rubini, nga ari.

(1989)

PAS PUSHTIMIT TË LODHSHËM

Dhjetë muaj të gjatë u rrëkëllyen
Pa asnjë zog poezie në gemb,
Dhjetë muaj të mollëzuar
Me hijen e thimthin shlligë,
U futën të banojnë në zbrazëtirën
E mugët të shelgut të vjetër:
Ta lexojnë veten bezdisshëm
E erës klithjet t'i bëhen digë.

Fati është i bukur e i shëmtuar,
Zemër e bardhë dhe e zezë pleh;
Rasti i ruan të fshehur nën gjuhë
Trëndafilat e fjalës me fener,
Moti e shkrep vetëtimën në shkëmb
Të ta kujtojë buzëqeshjen përdreq
E ëndrra të rrijë larg e larg
Gjékundi pas lisit e fjalës sterrë.

Thellë në zemër të zjarrit përpëlitesh
Në çastet e zbrazëta të rrugës tënde,
E n'rrugëtim - mjegull e tym, shi e diell;
Dyshimet e vjetra i tymos mbi krënde:
Nën shputa prush, në sy - lule,
Po edhe borë e barë gjithkund;
N'rërishte era rërën ta vjedh,
Në det, n'thellësi, dallga t'përkund.

(1989)

E KUNDËRTA E TË VËRTETËS

Të pavërtetat janë kalikule,
Që bindjen e ulin n'postiqe,
Po edhe në pluhur, edhe në baltë
Që sa më të besueshme të duken.
Të pavërtetat janë barrojë në vis,
Edhe ndryshk në hekur,
Janë lerth që trungje mbështjellë,
Dhe tinëzare me motive maska,
Qerre të prishura që u ciatin rrotat.
Të pavërtetat s'janë mini paga,
Po janë qelb që mbledh plaga
E të tajisin s'kanë të sosur.
Të pavërtetat janë maska të zbrazëta
Ku çërcëritin minjtë e uritur.
Po mbase ata janë edhe kobi?
Për të gjorët ndonjë dobi?

(1989)

ERA E LODHUR

Fryn era e lodhur
Në thellësinë e pafund e të errët
Nga një vis me ajër nëpër xhepa,
Nga njerëzit e vdekur
Që ende flasin e bërtasin
Në gjuhën e trashur
Me kërcëllitje dhëmbësh,
Me skërmitje eshtrash e nyjesh.

Fryn era e lodhur
E nëpër urëza fosforike
Heq valle e paqena
(E qenë sa për të qenë)
Në këmishën e stinëve
Ndërmjet këtyre gurëve,
Ndërmjet meje e hapësirës
Me frymorë që s'vdesin.

Fryn era e lodhur
Nëpër një kanion përplot
Shkëmbinj të shpuar nga stuhia,
Përplot kujë ngulçitëse,
Si kortezhi me të dalë nga varret
E të vdekurve, për sytë e humbur.
Në pikën mbështetëse të qëllimit,
Që asnjëherë s'e arritën të gjallë,
E të arrinë, në vazhdimin e tyre,
Ende s'pushojnë!

(1989)

PAK PUSHIM

Pak pushim, o ju vatra hallesh,
Pak pushim meritot për ju,
Edhe pse kafshata e dhembjes
Nuk kapërdihet lehtë.
Një pikë loti një inxhi
Nëpër fytyrat e rreshkura -
Vazhda të thella mundimesh.
Ata bumballa, që morën të Bukurën,
Tash fshihen në anën tjetër të hënës,
E në zgavrat e saj të thella,
I strehojnë larvat e veta.
Pak pushim, o ju djega,
Pak pushim për ëndrra të reja,
Edhe pse e gëlltitni lotin
Duke i rënë fyellit,
Për ta veçuar të ligën
Nga e Mira, që rrallë vjen.
Pak pushim, o ju të njohur
E të panjohur, për mua,
Pak pushim zgjimesh
Deri te zgjimi më i ri!

(1989)

FLUTURËS

Më erdhi lehtas në letër të bardhë
E mandej u çua duke i rrahur flatrat,
Pas fluturës erdhi vargu i ri,
Ishte pranverë.

Thashë: Pranvera i sjell fluturat.
Më erdhi sërish në letër të bardhë
Dhe prapë u çua me flatrat e lehta,
Para fluturës vajtën shikimet e mia -
Atëherë ishte verë.

Në vjeshtë më erdhi prapë në letër të bardhë
Dhe sërish u çua si përherë,
Thashë: Është vonuar stina e verës.
Në dimër, me mjegull e tym,
Më erdhi sërish në letër të bardhë:
Shikova jashtë dritares,
Binte dëborë e krongjijtë qenë varur në strehë
- Qenka gjallë, thashë,
Dhe ca pika lot në letër të bardhë
Erdhën në fund të këngës sime.

(1989)

YLLI I KËNGËS

Një zë i dashur kur të lutet me ngulm,
Për diçka të vlershme,
Improvizohet madhështia e rrejshme;

Ofendimi është antikë e paharruar.

Para idealit lartësohen dy male:
Njëri është i pakalueshëm,
Kurse tjetri i panjohur fare.
Ndjenja për dallim përpëlitet.

Kur të arrihet në breng të gjakimit,
Rrugës së kureshtjes,
Mbushet boshti me ind dëshirash,

Andaj - në avlëmend të kohës
Enden stinët që mbahen mend,
E ylli i këngës çohet më lartë.

(1989)

POEZIA QË KËNDOHET

Më mirë është të dallosh
Me intuitë të çalë,
Sesa të marrësh rrugën e parrugë
Që ta ka zgjedhur fati yt i keq.

Populli, që të merr në duar,
Është gjeni i pasharë:
Kurse ti je poezi që këndohet
Në rrugë për nga Bukuria.

Askush nuk e arrin majën më të lartë,
E dikush tjetër të qepet pas
Dhe më tutje e çon shqisën e gjashtë.

(1989)

PËRIMTIME

Njeriu, pa shpresë të kulluar,
Të turbullt e ka ardhmërinë.

Lumi, me urë të fortë,
I përgëzon brigjet e ndara.

(1989)

PA PARTITURË

Stina është me dy hënëza barkushe:
Në njërën netët janë të qarta
E në tjetrën - të kundërta -
Derisa njëra kthjell,
Tjetra dhuron një dimër borë në kokë,
Andaj njerëzit janë të vdekshëm.
Pavdeksinë e kanë vetëm gjurmët e thella
Që mbeten të jetojnë në sendet e forta.
Njeriu sa herë dëshiron aq herë vdes,
Për të rilindur i duhet entuziazmi.
Të keqen ta dhuron vetëm qëllimi i paqartë
Që s'mundet të të marrë pas.
Kënga që s'futet n'partiturë jetësore
S'ka lindur të bëhet këngë;
Ajo s'do të këndohet kurrë.

(1989)

NË ORËN E HISTORISË

Historia është një tempull,
Ku çdokush falet nga altari i vet:

Dikush ndjell të nesërmen,
E dikush të djeshmen,

Po ajo është edhe kështjellë
Me dy hije në kundërshtim.

Ato s'kanë fjalor të ndërsjellë -
Të dyja gjenden në dyluftim:

Kur mundet e vërteta,
Lavdërohet e pavërteta!

(1989)

LULET

Në botën e luleve
Dallohet shëmtia,
Në botën e shëmtisë
Çmohet lulja.

Zemrën e bart me vinça
Ndjeshmëria e luleve:
Po bëri e ra,
Mos u frikësohuni
Se po përplaset mbi ju:
Ajo vetëm ju prek,
Ajo vetëm ju përkëdhel
Dhe ju strehon saora -
Larg oleandrit
Të ëndrrave të dashurisë.

Lulet e ndjejnë
Çdo ngacim:
Gojë nuk kanë,
Po flasin me shikim.

(1982)

THATËSIRA

Në mungesë të shiut
Të çarat e tokës
Janë si gojë e hapura
Që piskëllojnë.

Verë e gjatë
E thatë
E thatë.

(1989)

VI MAGJIA E NARRACIONIT

NË LAGJEN TIME

Tjegullat mesnatës ia shkundi dita,
Mustaqet qetësisë ia shkuli një nga një,
Në vig e bartën për në ambulancë.
Shumë kumbulla të papjekura hëngri dita
Dhe mesnata e ndezi dritën në një dritare
E shpejt e fiku pas të lehurave shumë.
Në shelgjishte, thonë, ka ndodhur diç pa hije,
Rreth lumit është ndjerë një fëshfërimë,
Anës malit ujqër kanë parë shumë,
Të gjitha këto i barti era në shpinë
Dhe koka u tund në shenjë moskënaqësie,
Ngjarjet e natës për t'i radhitur në penj.
Në mëngjes ditën e sollën në këmbët e veta,
Kumbullën e porositën kurrë më në jetë
Frute të papjekura të mos i japë,
Por në vend të tyre i dhanë fjalë të tilla!

(1989)

KONTRAST

Prej dikah ia behu një i pashëm:
I ri, i krehur, i mëjmë;
U fut i pari në rresht,
Duke shtyrë me bërryla në dy anë
E duke lënduar pak një plak.

S'mundja të rri pa i thënë
Se radhën s'e kish ashtu,
Po si të të gjithë - kështu,
Ta respektojë veten
S'i del gjak aspak.

Ai një sërë fjalësh “të urta”
I lëshoi breshër mbi llamarinë
Dhe e kreu punën si mendoi.
Plaku pranë meje shtoi:
“Mos fol, o mik i dashur,
Unë edhe në shtëpinë time s'mundi...”

Pasi kaluan njëzet e katër orë,
Në dritaren e vogël u sha
Lagje e Vjetër për këtë,
Andaj thashë: - Për njërin,
Që e mësoi vetëm për të mirë,
Pësoi që të mësojë tërë Lagjja!

(1989)

PAK KOHË PËR KOHËN

Ti je i mashtruar nga dirigjuesi yt
Dhe ëdrrat i barazon me fundin e ditës.
Sa është ora? Akrepat ia ke harruar
Në sofrën e genit të sosur me zero
Dhe s'do të arrish kurrë në qëllim,
Për të bërë vrapimin e përcaktuar.
Dyshimet janë kapur fort për degën e fatit,
S'do të arrish t'i shkundësh në kohë,
Kur do të kuptosh se duhet të jenë pjekur.
Ka mbetur edhe pak kohë për kohën
Të kuptohet se ç'bluan në mokrën e vet:
Fjalë boshe, kokol, egjër, apo gogla dushku?
Dëshirat e kota barazohen me mashtrimin tënd,
Kurse koketimi i zbrazur, me disfatën tënde.
Ortaku yt ta ka hëngër përseshin
Dhe të ka urdhëruar t'ia lash çanakun.
Ti i kupton gjërat, kur t'ua shohësh brirët,
E ata mund të jenë shyt në oborrin tënd!

(1989)

MOS QE E MARTË

Një rrëfejë shtatë herë më tregoi
Një njeri, që s'e pata njohur gjer atëherë.
Qe duke dhënë shpirt ajo verë,
Kur posa i njohuri me vardisje shtoi:
- Çka bën me të ligat kur të marrin pas,
E janë aq të ashpra në shikime:
Ata t'i zbutësh u falish përkëdhelime,
Apo nga një arsye në kokë ua përplas?
- Në të parë u habita, i thashë: Seç janë...
- Të brejnë, apo jo? - më tha hidhëruar.
- Shpirtin të tërin e kisha farmak,
Po heshta që era lajmin t'ia sillte n'vesh.
Nga fjalët s'dukej se ishte i qartë:
S'e di se a qe pranë meje dikush,
Që flet jerm nga gota zbraz e mbush,
Apo mbase dita mos qe e martë?!

(1982)

FAJËSIMI

Të pikturonte jetën dorën askush
S'ia lojti, e as në vesh fjalë
E mendime s'i tha. Pse u rrope
Aq keq e s'u lodhe, pra? Pse vetëm
Tha se dashurinë ia fali dikush?
E ngrohtë dashuria më mirë se atij
T'u fal e t'u dha ndihmë e krah
Special, dihet vetëm një gjë
Se dikush për ideal e paskësh në gjak
Të shajë dhe mollë e lajthi.
Nga vargjet nuk jetuan as poetët
Me kurorë, po s'ke ç'i bën
Zjarrit të madh që shpërthen në gji
Erupcion mbi malet me dëborë.
Por, i dashur, prapë zemra e tij
Të përfaqon: poeti për poetin
Se është mik e di, si s'e ditke
Se t'vërtetën e kanë pasion?

(1983)

PIKË NË RRETH

Shëtiste një njeri i çuditshëm kaherë
Me një kurorë të madhe - në fshatra e qytete
Dhe atë që e kish mësuar për vete
Donte t'ua mësonte turmave në atë verë.
E ata të gajasur, sytë te kurora,
Ia ndiqnin zotësinë. - Ke kurorën kurth,
Imiton rrejshëm gjithësinë! - i tha
Një djalosh, kur iu qas më pranë...
Njeriu i çuditshëm me kurorë, u hidhërua
Në fillim, po djaloshi i tha shtruar:
- Një rreth dosido bëre kot! - Dhe ai
E vizatoi me shkop në pluhur, nxituar.
- Ky rreth është bota. Vëj pikë në të!
Kjo pikë është dituria jote sot e mot.
I bindur, njeriu i çuditshëm me kurorë,
Kurorës së vet i dha ngjyrë të padukshme:
Mandej vërshëlleu gjëkundi nga turma
Dhe koka e tij zuri të ndriste me nur plot.

(1983)

TAKIM RASTI

Nikoqiri u përpoq mysafirin ta njoftojë
Me një hijerëndë, të ngjashëm me ata
Që kthehen të graduar nga pelegrinazhi.
Ai, si ta kish pasur gjuhën në hithra,
Mikut të vet ia ktheu pa vonesë:
- E di, s'ka rëndësi, aty-këtu
Ekspozon emrin, që s'i ka vlerë...
- Në qiell shpërtheu një flakë
Me dritë të fortë, gati verbuese.
Dhe mysafiri i fyer pa një arlekin demode
Sesi krijohet në një lokal dionisian.
Në holin hënor e futi kokën turbull
Në mes shuplakash dhe, para tij,
Parakaloi rrugëtimi i pasosur i vargjeve
Me hënën që krijonte hënësinën e Muzës.
Nga vargjet u shkëput posa i njohuri,
Mbeti gjëkund ta përpushte hirin
Në zjarrin e shuar nën një lis:
Me atë që do ta gjente brenda mërtis
Iu dha rasti ta biberoste hijen
E krenarisë së vet - prej krenarisë!

(1983)

KUR FOLA UNË TI S'ISHE MË

Kishe dëshirë të rrinim pranë e pranë,
Kur shpjegoje, të dëgjoja me kujdes,
Si shpuza ujin t'i thithja mendimet tua;
S'të kisha parë në tjetër vend kurrë.
Kur flitje heshtjen e kisha urti,
Të dëgjoja me kujdes deri në harrim
Ti në dashurinë time ishe fare i rrallë,
Dhe kisha dëshirë të flitje sa më shumë.
Unë të kurseja pamasë nga harresa,
Dhe me heshtje shpreha nderimin ndaj teje.
Por, kur mora të flas unë, ti më s'ishe;
Heshtjes sime aktive i dhash përgjigje
Në vetminë time krejtësisht të qetë,
Kurse ti u ndave pa u përshëndetur.
Që atëherë telat e lyrës u bënë all,
Ajo gjithmonë të kërkon me natë e me ditë,
Po meqë s'je më në poezinë time i rrallë,
Borxh ta pata thjeshtësinë e kësaj kënge.

(1989)

VII NËPËR UNAZË

NË BOTËN E MAGJISË

Me diell e hënë mbi supa
Trokita n'çdo derë, kudo...
Nëpër poret e pamundësive hyra
Në mbretërinë e buzëqeshjeve,
Por askund nuk të pashë...
Erën e urdhërova
Të të vërshtëllejë në vesh -
Me tingujt e mallit, ngashërimit
Ta pëshpëritësh ardhjen time,
Por prapë nuk të pashë...
Ujin e detit me grushta e qita
E nëpër algje t'kërkova -
Me det thirra e thirra
E i tëri u shndërrova n'jehonë,
Por - kurrkund s'të gjeta...
Tash, i dëshpëruar u ula
Në hyrje të ëndrrës
E ti e ke hedhur syrin n'agim
E m'shikon prej luleve -
Në botën e magjisë së pritjeve...

(1966)

NËPËR UNAZË

Nëpër unazën e pritjes kapërdihet shpresa,
Nëpër unazën e shpresës - mashtrimi,
Nëpër unazën e kohës - karvani i shekujve,
Nëpër unazën e visit - pylli me zogj,
Nëpër unazën e luleve - fëmijët e fluturat,
Nëpër unazën e fjalës së bukur - muzat,
Nëpër unazën e zjarrit - heronjtë,
Nëpërmes skilës e haridbës kapërdihet guximi,
Nëpër zemrën e Odiseut përbirohet Itaka.
Çdo gjë e ka nga një unazë për t'u kapërdirë.

(1982)

NJERIU

Të jetosh
Duke menduar për jetën
Domethënë -
Të duash njeriun.

Rrënja e jetës është
Pika më e vogël e ujit
Që e përbin
Kurmin e gjithësisë.

Si në zemër të kozmosit
Biem furishëm
Në pafundësinë
E botës së njeriut.

Njeriu është
Tokë e etshme për shi
Dhe frut i merakosur
Për diell.

Botën e transformon
Ndër lëvizje
Duke ia ndërruar
Anën e errët.

(1982)

NË VEGIM

Në visin Etonë emrin e vet
E kish humbur një vashë e dëgjuar:
Thirrjet e shumta i shqiptonin emra
Më të ndryshëm të fisit etonas,
Po oshëtima e zgjatur në thellësi të pyllit
I shpuprishi kuptimet e tyre.

Atëbotë thonë se themeluar është
Zanafilla e historisë së shqetësimit:
Aty ku mbaron kufiri i kërshërisë
Dëshira do të bëhet vazhdimi i saj.
Dhe në mes këndjes e vullnetit
Digjet në vegim flijimi i ri...

(1982)

ZOGUT NË FLUTURIM

Hesht,
O zog në fluturim,
Mos ma pëshpërit
emrin tim!
As në Nazaret
E as n'dhomën time
S'jam i huaj,
Po ekzemplar i palëvizshëm
Jam bërë
Në botën e sendeve,
Që me kujdes
I ruaj.

(1982)

VLIMI

Ta mbaje me vete atë
Që dëshironte të erruptonte,
Ishte si të përbihej i gjallë
Një det prushi e hiri;

Ta mbaje me vete atë
Që ta brente palcën e shpirtin,
Ishte e barabartë me vdekjen
Pa emër e lavdi.
Kush mbetej të heshte
Me gjithë atë lavë e prush,
Pa nxjerrë as të vetmen klithje,
E digjte botën e ëndrrave!

(1982)

PIGMENT

Kaçë është kryelartë:
Selinë e prehjes e ka
Nën hijen e trëndafilut
Që e përbuz!

(1982)

SHËRIMI

Ky lis është i ndjeshëm:
Tepër i dhemb koka
Nga krrokatja e sorrave;

Zëri i bilbilit e shëron
Në flautën e vashës,
Që i përkulen edhe yjet.

(1982)

PIKA

Në shpellë eksplodon,
Në qiell është vetëtimë
E retë e zeza i gris;

Është edhe shqetësim,
Kur lumi turbullohet
E yjet vishen me të zeza.

(1982)

AJO BOTË

Duke ngarritur
Shpjerë rrugëve jonormale
Ajo botë marroqe,
Ajo botë hutaqe,
Ajo botë fitimesh
E humbjesh fatale;
Ajo botë thumbash,
Ajo botë plumbash,
Ajo botë puthjesh vazale!

(1971)

PAQE

Paqe, ju lutem, vetëm paqe
Për barin e sfilitur
Të shkelur përbri rrugës;

Paqe për lareshën krahëlënduar
E të ngjuar në kafazin
E senatoriumit të përgjakur;

Paqe për buçitjen e jetës,
Për ëndrrat e bukura,
për dëshirat e pajetuara!

(1982)

UNAZA

Unaza e dashurisë fshihet
Nën gjuhë të gjarprit
Në mezhdë të kohës e kohës
Te pojata e kashtuar
Me flokët e natës,
E cila braktis fronin
pas këngëve
Që shprehin gëzimin
Me unazë në gisht
Të agimit.

(1982)

DEGA E QYQES

Kur u përplas shtriga në shtat të liqenit,
Qielli u vrë, e humbi formën, u shpërbë
E qerrja e rrugës së diellit ciati dhembshëm.

Atëherë thonë se u bë një tronditje e madhe:
Fati i plagosur mbeti me të meta serioze
e qyqja një degë në pyll e lypi me tapi.

(1981)

MAKTHI

Krojet me radhë futen në jetë
e shqim shndërrohen në një det.

Det o det, durimtar ti më je:
T'lëvizin dallgët nga sikleti,
E mbi shtat të rri një re.

Hija e makthit të ha ngadalë
Dhe nga kurmi të ngel skeleti,
Ta grimcon dhe atë me fjalë.

Kur të të vijë gjuha në dhëmb,
Makthi bie me kokë në shkëmb!

(7 korrik 1991)

VIII

DËBORË NË HIRISHTE

LAGJJA E KOTICAJVE¹

Koticajt janë pinjojtë e rrënjëve të Lisit të lashtë
Ndër të cilët atom që kapërcen veten është Plaku,
Që në zemër e mendje i bujti Muza e hershme.
Plaku bart një mirjadë vjetësh me mundime,
Lojërat e fëmijërisë i ka gurëzuar n'kujtime
E në shpirt i bëjnë kryengritje një sërë djegash.
Në sytë e tyre, që e njohin, është i barabartë
Për nga gjymtyrët dhe për nga llakërditë e jetës.
Shqisat s'ia përpushin nga hiri ta njohin ndryshe:
Ai këndoi tërë jetën n'ilegalitet e u vetëquajt poet.
Andaj, ju lutem, të mos i kushtoni kujdes,
Deri më sot askush s'e ka nxjerrë nga margjinat.
Meqë është i Lagjes, që s'e njeh askush,
Është sinonim i saj, është vetëm një numër,
Që e vazhdon fisin e anatemuar nga harresa.
N'atë Lagje ka mbetur një burim i tharë ndjenjash,
Një derë e kyçur për botën e imagjinatës
Dhe një shtangim i çuditshëm i shpirtit laik.
Tash koticajt përpiqen të shndërrohen në bukureza,
Për ta krijuar hënën e vet të prerë me shpata,
Për ta gjetur yllin e vet të fshehur nga nata
Gjatë mashtrimeve, depërtimeve, ngulitjeve
Të shakullinave, që shkaktonin endje marramendëse.
Plaku me lyrë shëtiti këtu, kur e përflak malli:
Nga koka i gëlon një krua magjie prej mali
Me një det idesh, që lëvizin, pëshpërisin,
Me një qiell yje ndjenjash e me një shpirt kometë,
Për t'ua bërë të njohur tingullin, që ua lë hapi
Dhe zemrën e vet t'ua falë ta shpalojnë n'qetësi.

(Fshati Gajre, 24 nëntor 1990)

¹ Lagjja e autorit në fshatin ku u lind e u rrit.

MONOLOG

Ti futesh në hierarkinë e fjalës që s'ka parajsë
E ajo të zbukuron me meritat që t'i vër n'rabushë
E mbase ti kujton se përjeton zgjimin e vërtetë.

Nëse përpëlitesh, e hija jote zbehet dalëngadalë
Seriozisht të ka braktisur njëmendësia e kohës
E duhet të mos fshehesh pas premtimeve të zbrazëta.

Çdo fjalë që vjen e stolisur, e molisur prej jete,
Është e barabartë edhe me fshehtësinë e zeros
Të zhveshur fare nga numrat, që duhet t'i prinë.

Ruaju nga emrat pa jetë që të lënë pa emrin tënd,
Stolisu me realitetin, që e meriton pagëzimin
Dhe kurrën e kurrës mos shkel në të njëjtin vend.

Ti sheh diçka, konstaton, gjykon mirë ose keq,
Andaj më shikon në sytë me ninëz fort të zmadhuar
Dhe ke hapësirë e hapësirë që të futesh në mua.

Por - ti s'je unë, as unë ti, që të dy jemi dy
Dhe për aq kemi mundësi e kapacitet të mjaftueshëm
Të shohim më mirë, kur i trashet qafa rrezikut.

Nëpër zigzag të ecësh s'është si nëpër vizore,
Nëpër të parën të nevojitet gjykimi piqeziej,
Nëpër të dytën ndryshon: koha s'ka kohë të piqet.

Ti, nëse e do fëmijën tënd, sosi çapat e tu
E të mos të puliten sytë edhe për një çap të ri
Që mund t'ia marrësh vetes hua nga pamundësia.

Ti di se ç'kohë i ke rrëmbyer pakohësisë në kohë
Hapësirën e këngës tënde të dashur rrethoje mirë
Me ngjyrën e dashurisë së pamatur të gjakut tënd.

Dhe në mes të atij rrethi stisu një orë e saktë
Që numërimi i kohës të ketë emrin e vet të vërtetë
Përgjatë emërtimit të hapësirës me emrin tënd!

(19 dhjetor 1990)

TRIPTIK

1. - BËRTHAMA E ZJARRIT

Kur t'i qasesh bërthamës së zjarrit,
Frika e shkatërron epiqendrën e saj.
Kur t'i ikësh bërthamës së zjarrit,
Frika i merr pas mundësitë mbrojtëse
Dhe kalon në panik të paarsyeshëm.
Mundësinë për ngushëllim të mundshëm
Nuk e sheh nga çorientimi i rastit.
Duke mos e njohur as gjurma gjurmën
E të njëjtës këmbë të të njëjtës farë,
E as gaca gacën e të të njëjtit zjarr.

2. - ESENCA E GJURMËS

Esenca e fjalës e ruan esencën e gjurmës
Që të mos bdaret në mejtimin e vet
I cili e mbron nga nëntoka e demonit,
Që s'e ka fuqinë e hirit të fjalës sate.
Nga mejtimi mbrojtës është gjurma jote
Më e sigurt ngase e njeh më së miri
Dhe ngase Tokën që e prek të jep fuqi,
Pse të njeh aq sa e njohish edhe ti.
Dhe apatia shndërrohet në elan të ri,
Shkatërron bërthamën e qëllimit të zi.

3. - EDHE PAK KOHË

Gurgullima e pakësuar e ujit te kroi
Është pakësimi i ujit nga krongjijtë.
Ruaju të mos t'i kapë mendimet acari
I hutimit të paikshëm nëpër krongjij.
Te kroi, një ditë, krongjijtë i shkrin
Era e jugut, përroi do të gurgullojë.
Po fjalëve, të mendimeve drithëritëse,
Acari fanatik u futet deri në thembër.
Dhe do të duhet madje, edhe pak kohë,
Dielli i ngrirë të shkrihet në zemër!

(28 korrik 1991)

BRIRI

Më rrethojnë me shikim të pushtë
Fytyrat melankolike të luleve,

Prej të cilave varet koha ime
Dhe shërimi i plagëve të saj.
Plagën që s'shërohet e fsheh
Nga sytë e thëngjillit të fjalës,
Kuptimi që s'ka kuptim aspak
E mbron qëllimin e paligjshmërisë
Që zjarri i ftohtë t'i sosit
Para akullit fare të nxehtë.

Më rrethojnë me shikim vezullues
Fytyrat e guximshme të yjeve,

Të cilët m'i dërgojnë sinjalet
Nga rrënjët e pemishtes, që më ushqen
Me zhurmën e krimbit në dru.
Ikjen s'e kam obsesion që vjen
Para syve të rrugës dhe të parrugës,
Yjet më marrin në botën e vet
Dhe më kthejnë në botën e pamundësisë,
Për të ma zmadhuar syrin e tretë.

Më rrethojnë me shikim të mprehtë
Fytyrat e sinqerta të vëllezërve

Dhe fjalës sime i bëjnë homazh
Pasi të vdesë e rilindur në këngë
Me një stinë me orë të re autoritare.
Prej meje fluturojnë të gjitha rrugët,
Që bartin flakadanët për në ferr
T'ia djegin ëndrrat pakuptimësisë,
E nga hiri të lindë qytetërimi i ri
Duke dalë koha nga briri i dhisë!

(2 korrik 1991)

**RRUGA PËR NË FERRA
DREJT LULISHTES SHPJERË**

Deri te kaçuba soset zhaurima e natës
Dhe fillojnë bisedat e ngrohta të ditës.
Rropamën e ligë e shkelin udhëtarët
E ritmin e krojeve e miklon mëngjesi.
Fjalët e mia kërkojnë vend në kujtesë
Dhe i bart burimi i parë në shpresë
Deri te buzët e rreshkura të dritës.
Fillon loja në fshehtësinë e rritës
Midis brengës, shpresës dhe rrojtjes
E të misterit të shkrirë në dashuri.
Nëpër muret e kaçorres së braktisur,
Gjëkundi përbri liqenit të trazuar,
Këndon bufi, qyqja dhe koha e molisur.
Avulli i nëntokës atje arrin i heshtur
Dhe shuhet ngadalë e bëhet pika vese.
Majës së currit reja mbi kokë i rri,
E shpon me thika të nxehta e me akull të zi.
Shqiponjat i bëjnë rrahë observimi,
E shërojnë dhe futen në zemrën e tij.
Mjegullën, që është rreth i huaj udhëtimit,
E davarit gjuha e ditës me pranishmëri
Të mos e humb durimi energjinë shqim
E të mos e trënd karpën e hidhërimit.
Dhe zërat, që gjatë n'kaçubë qenë strukur,
Tash lidhin frute në pemën e guximit.
Jehu, që duhet dikah t'i vijë këngës sime,
Nuk është as çast as rast mosafrimi.
Mos më bind për kot, fjala të ka përmjerë,
Kur më thua e shëmtuar, mua më del e bukur,
Rruga për në ferra drejt lulishtes shpjerë!

(19 dhjetor 190)

IMAZH MEDITUES

Të mos humbësh kohë, mos u ngut, çapo ngadalë;
Edhe pika e ujit është e rrallë, po gurin shpon.
Mëkatesh pastrohemi me mëkate të lara,
Ëndrra e paqartë është gjithmonë e qartë,
Gëzimi i tepruar është zambak që vyshket shpejt
Dhe rigë shiu në pluhurin e dendur të rrugës.
Gaca pranë gacës prushin e ka më të fortë,
Histori nuk është populli, po Nazareti i tij.
Populli është abecejë e Nazaretit zëdhënës,
Që ndahet në shkronja të zëshme e të pazëshme:
Të zëshmet ua japin zërin të pazëshmeve
Dhe krijohet historia e ftohtë me zjarr,
Po më e nxehtë me akullin e ndjeshmërisë.
Ai që s'mendon fare, çdo gjë e ka të qartë:
Më shpejtë heq dorë nga terri i të vërtetës,
Merr e jep e jep e merr nga kotësia n'kotësi.
Mos e tepro me ngutjen tënde, vepro idesh;
Ngadalë mendo e më shpejtë qëllloja qëllimit.
Qëllimi është shenja më e errët për syrin,
Por më e qartë për imagjinatën pa rutinë.
Dy minusa ta nxjerrin shpirtin për një plus,
Midis dy stuhive dallga më e lartë në det:
Ti gjendesh mu në mes e s'di ku të përplasë;
Di ku të përplasë, andaj e njohish rrezikun,
Po njeriu s'është rob, derisa mendon për lirinë!

(4 dhjetor 1990)

FSHEHTËSIA

Aftësia ka fuqi në identitetin e vet
Dhe vizioni i opsionit magjik
I bëhet amalgam shkathtësisë
Të shndërrohet në mundësi syçelësie.

Pasi zhduken gërmadhat e vertikales,
Vdesin gjarpërinjtë e nakatosjes.

Yjet e pritjes po rriten dalëngadalë
Që t'i ngrinë djersët të shkuarës.

S'i lehtësohen njohurisë ethet e jermit,
Në mes durimit e rezistencës pasive
Trëndafilishtja me bilbil në bli.

Dhe në botën e ballancimit i huajnë:
Kuptimi relativ kuptimit të rysisë,
Guximi desident guximit të fshehtësisë.

Ja rrëpina e mendimit të paarritur,
Sekreti pa hije është edhe satan.

(12 shtator 1990)

OMNE HOMO

Emri i lirisë është i imagjinuar,
I lirë është njeriu OMNE HOMO²,
Sa për vete edhe për tjetrin.

Shpirti lind ndaras nga kurmi,
Që të ketë nevojë të bashkohet,
Për të jetuar edhe kurmi me të.

Numri një kërkon numër tjetër,
Për t'u bërë dy i njënjëshëm,
Mu si një nëpër dy njësha.

Emri robëri është paradoks klasik
I lirisë së robëruar me liri,
Që prapë të flitet për robërinë.

Të gjithë do të jenë të lirë,
Kur njëkohësisht do të jenë pengesë
Dhe ç'pengesë e dëshirave të veta.

(1 korrik 1991)

² OMNE HOMO (lat.) - krejt njeri.

GULFATJE

Të jetosh domethënë të ëndërrosh,
Të ëndërrosh domethënë të jesh.

Jemi njëkohësisht hapësirë e kohë
Që të ëndërrojmë plot zjarr dëshirash.

Zjarri thonë është edhe akull,
Po edhe akulli - zjarr skëterre.

Ka zjarr edhe në tru, edhe në zemër,
Zjarri në ide është dritë e fortë.

Zjarri mund të lindë edhe nga deti
E deti mund të lindë edhe nga zjarri.

Zjarri s'është dukuri e gabuar,
Po dukuria e gabuar është edhe zjarr.

Fëmijëve të prapë, që lozin me zjarr,
Nënat ua fshinë lotët, po edhe hirin!

(24 nëntor 1990)

HIDHËRIMI

Nipat u vunë qivurë të rinj lapidarë
Dhe mbeti vetëm kujtimi për gjyshërit.

Mblidhi gërhatjet e dritareve të mbyllura
Dhe shndërroni në muzikë makabre,
Mbase shohin ndonjë ëndërr të keqe!

Frutet e dashurisë kthehen në krahun tjetër
Dhe harrojnë se bërthama pup në këmbë
I pret me burim jete nëpër duar.

Kur do të zgjohen vonë, do të shohin
Se koha dhe qielli janë hidhëruar!

(3 mars 1991)

PA KOHËN TIME

Një kohë s'jam i kohës sime
Pa kohën time,
Një kohë s'jam i vetes sime
Pa mua, me mua.
Fjala ime është realiteti,
Që përpëlitet nëpër hi;
Është Planetë me hënëzat e saj,
Me dhembjen time
Me mua, në mua.

Fëmijët i mbushin duart me ajër,
Bien në shtrat
E s'i merr gjumi:
Nëpër dritare,
Në majë bliri,
E kapin hënën me qepallë
E marrin fener në dhomë
Ta futin
Në botën e ëndrrave!

(28 nëntor 1989)

BUMERANG

Dhjetë thasë mërzia
Nuk m'i ha as dhia.

Ia përplasa n'fytyrë
Dorës që m'i dha
Me mllef e mynxyrë.

Tash eci mbi tokë,
Nëpër jastëk uji,
Me miza në kokë.

N'lëmin që do t'shohet
Mullar duhet t'vihet.

(22 korrik 1991)

VETËM KËNGA

Derisa qe gjallë
Pak nga pak e vranë,
Që të vdiste një herë
Në ditë;

Kur vdiq përgjithmonë,
Nuk ishte më
Që të vdiste
Përditë;

I mbeti vetëm çiftelia
E varur në mur
Dekor etnik
Për kujtim;

Dhe kënga e tij,
Plot dashuri,
Ndër shokë e miq
Ngushëllim.

(3 korrik 1991)

DËBORË E HI

Nën këmbë diç më ik
E dëbora shtohet
Që nga rrëza n'kikë.

Rrugët e mia,
Gjurmët e mia,
Nishanet e mia
Hiri i mbulon.

Diç tragjike,
Diç komike,
Diç e dhembshme
Më mundon.

Nën dëborë e hi
Nuk mund të flas -
S'kam fuqi!

(28 nëntor 1989)

EPITAF

Jam këtu, atje, poshtë, lart;
Jam dje, sot, nesër - përherë.

Kam qenë gjithëkohërave,
Do të jem gjithëkohërave.

Edhe i gjallë kam qenë i vdekur,
Edhe i vdekur kam qenë i gjallë.
Meqë vdiqa edhe i gjallë,
Edhe i vdekur do të jetoj!

(24 nëntor 1990)

IX
FANTASTIKA E
ABSTRAKSIONIT

QË DIHET E QË NUK DIHET (PROLOG)

- Natura non facit saltus.¹
- latine

Djathtas-majtas, poshtë-lart, para-pas,
Janë pesë mrekullitë e Misterit:
Toka, zjarri, uji, ajri, koha;
Çdo element i shtatës ka pesën e vet!

Vetveten ende s'mund ta zbuloj
As në tokë,
As në zjarr,
As në ujë,
As në ajër,
As në kohë,
E në të gjitha jam pjesë-pjesë,

Në tokë e kam të pamurit,
Në zjarr të prekurit,
Në ujë të shijuarit,
Në ajër të dëgjuarit,
Në kohë të nuhaturit.
Shqisën e gjashtë gjykatore në të gjitha.

Organin e tretjes e përbëjnë pesë pjesë,
Ekstremitetet e trupit janë pesë,
Trupin e përbëjnë pesë pjesë,
Kontinentet janë pesë, racat pesë,
Që dihet e që s'dihet
Krejt numërohen me pesë, me pesë, me pesë...

(20 korrik 1991)

¹ Natyra nuk bën kërcime (parimi i kontinuitetit, sipas të cilit zhvillimi i tërësishëm në natyrë kryhet në mënyrë organike dhe shkallë-shkallë).

TOKA

Toka është gjallesë e vdekur numrash dysha,
Ajo është e vdekur, po i gjëllinë bërthama.
Katër anët e saj i përlind lëvizja e amshuar
Që është e vendosur në anën e pestë të saj.

Rrotullimin e parë e bën për hir të jetesës,
Rrotullimin e dytë - për hir të qëndresës,
Rrotullimin e tretë - për hir të bashkimit,
Rrotullimin e katërt - për hir të amshimit.

Ana e pestë e Tokës ekziston vetëm në intuitë,
Ajo është kur s'është dhe s'është kur është.
Intuita kur për të s'di aspak, mendon se di;
Kur zë të dijë, mendon se ende asgjë nuk di.

Dija e mosdija janë të përlindura në gjithësi
Pas katër elementeve. Dhe koha si faktor
I nxit digresionet, e mandej - bien n'ujdi,
Që dijenia ta zgjojë Tokën, ta futë në katror.

(4 gusht 1991)

ZJARRI

Në mes numrave dysha të Tokës jeton zjarri
Dhe dyshash brafullon, kur ato dashurohen,
Dy të njëjtat kur i fërkon kundërshtari
Zjarri brafullon mbi dyshat që zemërohen.

Zjarri s'duket, po është shpirti i Tokës,
Dhe dukuria është bashkimi i numrave dysha,
Po dhe formë e njënjëshme e natyrës së Botës
Me bashkimin e tëra dyshave që i zë këmisha!

Toka pa zjarrin nuk do të jetonte kurrhiç,
Si njeriu pa shpirtin, që bëhet vet hi.
E hiri bëhet dhe nga numrat dysha në diç
Që jeton me Tokën, pse zjarrin e ka në gji.

(4 gusht 1991)

UJI

Toka dhe zjarri gjallërojnë për gazep,
Uji nëpër damarët e Tokës është gjak.
Tokës dhe zjarrit uji gjallëri u jep
Dhe jeta vazhdon, por disi nën kapak.

Fshehtësia për vazhdimësi ende vazhdon,
Trup me zjarr e gjak, por i heshtur hala.
Tokës i duhet dhe diç, që e ngacmon
Pas perdes të mos ngulçohet ajo pada'.

Gjaku vetëm e freskon t'ia heqë zjarminë,
Po ende s'i ZBUKUROHET shtati e fytyra,
As ZHURMA madje nuk ia prish qetësinë,
S'ka askush ta vazhdojë në një mijë mënyra.

(4 gusht 1991)

* & zbururimi - Flora; & zhurma - Fauna; & vazhdimi - Njeriu.

AJRI

Tokës, zjarrit, ujit, gulfatjen ajri ua vjedh
Dhe jeta e mbuluar zbulohet, po rri në vend
Pa bërë ndonjë lëvizje, që kahun e vet zgjedh
Të trasojë rrugën nëpër të cilën jeta ngarend.

Kur të katër elementet e Misterit të jenë,
Duhet dhe diç tjetër që lëvizjen saktë e matë,
E që të flasë të vërtetën e vet, nuk menë
As në të mijtën e sekondës, me ditë, me natë.

Toka merr frymë dhe kollitet nëpër kraterë,
Fetusi ngushëllon jetën e jeta vazhdimësinë
Nëpër ujë, ajër, zjarr; nëpër gëzime e tmerre
E përkud, e shkud, ia dhuron përjetësinë.

(4 gusht 1991)

KOHA

*“Ve duha ve lejli idha sexha².
- Sipas KUR'ANIT*

Koha s'u takon elementeve të thjeshta,
Siç është toka, zjarri, uji, ajri;
Koha është faktor, është edhe Mister,
Po edhe vetë mrekullia e vetvetes;
Pa kohën elementet tjera janë të verbra.

Koha është edhe sensi subtil i erenive:
Të të pamurit në tokë,
Të të dëgjuarit në ajër,
Të të shijuarit në ujë,
Të të prekurit në zjarr,
Të të nuhaturit në imagjinatë,
Po edhe çelësi i magjisë së iluminizmit.

Ajo është edhe e gjashta pjesë e trurit,
Edhe kontinenti i gjashtë i botës,
Edhe ana e pestë e botës,
Edhe gjashtë gishtërinjtë e dorës,
Edhe tërësia e shtatë pjesëve të veta.

(4 gusht 1991)

² Betohe në emër të kohës (betim hyjnor).

ÇELËSI MAGJIK ILUMINIST*

Unë nuk jam ende unë, kur jam ende unë.
Unë jam ende ju, kur ju jeni ende unë.
Ju nuk jeni ende ju, kur unë jam ende ju.
Ju jeni ende unë, kur unë jam ende ju.

Në çdo hutesë përhumbet çelësi magjik,
Me të zbulohet lehtë fshehtësia e jetës.
Njeriu është gjithmonë derë e shkyçur,
Për të arritur çoç te shpirti i detit.

E njeriu është patjetër kozmos i vogël:
Kur e arrin gishtin e vogël, i madhi qesh.
I vazhdueshëm është njeriu në përpjekje
Rrallë duke dalë cazë nga lëkura e vet.

(20 korrik 1991)

* & iluminizëm-zmi - drejtim filozofik që rrjedh nga fjala arabe **ilëm** = dije, njohuri, dijeni, shkencë.

PAFUNDËSIA NË FUNDËSI TË PAFUND

Shtatë kat qiell - shtatë gallaktika:
Kozmosi përpiqet të jetë i paskajshëm,
Po megjithatë është i skajshëm.
Çdo gjë e fshehtë në fshehtësinë e vet
Dhe asgjë e fshehtë përgjithmonë.
Ideja në ideshmëri ekziston,
Gjeturia në imagjinatë qëndron,
Imagjinata në fantazi gërmon,
Vullneti inercionin mashtron,
Ekziston mënyra e jetës dhe stili.
Fshehtësia dorëzohet me fshehtësi,
Paskajshmëria mposhtet me paskajshmëri.
Kur të zbulohet shtata e shtatës,
Dihet se ajo i ka edhe shtatë të tjera
E çdo shtatë shtatën me ato vlera.
Dhe në rrumbullakësi e sos paskajshmërinë,
Që të bëhet e skajshme dhe e sosshme,
Për t'ia nisur që nga krijimi i ri
Dhe kështu gjithmonë në pafundshmëri.

(25 korrik 1991)

NË FUND FILLIMI (EPILOG)

Gjeni do të plakët nga përsosuria e vet -
Nga diskursi i të arriturave kulminante
Dhe Toka do të vuajë nga ngulçimi i rëndë
Hedhurinash të shumta që s'kanë ku të venë.
Atëherë është fundi për një fillim të ri,
Por tash nga arritjet që do të jenë fuqiplote.
Dhe pas gjenit të vdekshëm vjen pavdekësia
Që nivelizon arritjen tjetër më të re
Pas pastrimit të Tokës me zjarr nga gjithësia
Për dizenfektim, për frymëmarrje e ngadhënjim.
Toka sërish do të mbillet me Florë e Faunë,
Pasi t'i kthehet uji e ajri nga koha.
Dhe gjenit do t'i dhurohet aftësia e fundme
Për të qenë pafund nga një fillim i ri,
Për të jetuar i peshuar e stërpeshuar
Në kohë ciklesh jashtëkohore nga përsosuria.
Ëndrra e dashurisë do të jetë vetëm NURI
I SIMBOLIT të përjetshëm, në mbarë universin,
Që i jep urtisë rojtjen e nivelit të lartë.

(26 korrik 1991)

SHËNIME PËR SHKRIMTARIN

ABDYLAZIS ISLAMI u lind më 29 korrik 1930 në fshatin Gajre të Tetovës. Rrjedh nga një familje kurbetçinjsh. Që në shkollën e mesme filloi të merret me shkrime për fëmijë e për të rritur, por punimin e parë e botoi në vitin 1954 në revistën për fëmijë “GËZIMI” që botohet në Shkup. Që atëherë bashkëpunoi me të gjitha gazetat e revistat që dalin në gjuhën shqipe në Shkup, Prishtinë e Podgoricë. Kryesisht merret me poezi e prozë për fëmijë, të rinj e për të rritur, me tregimtari, me shkrimin e dramave dhe romaneve, po ashtu për fëmijë e për të rritur, merret edhe me kritikë letrare e eseistike, me mbledhjen e studimin e folklorit, me përkthime letrare nga maqedonishtja e diçka edhe nga serbishtja.

Punoi si mësues, mandej si arsimtar i gjuhës shqipe dhe si këshilltar pedagogjik deri në vitin 1970, kur vajti në Radio-Shkup të punojë si gazetar e mandej edhe si redaktor i emisioneve të kulturës e të arsimit deri në vitin 1979, prej ku doli në pension. Tash jeton në Tetovë. Gjatë kohë ka qenë anëtar i kolegjiut të revistës “JEHONA” që botohet në Shkup.

Poezitë e tij, si ato për fëmijë po ashtu edhe ato për të rritur, janë përfshirë nëpër antologji të ndryshme në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të huaja, si në sllovenishte, serbishte, maqedonishte, turqishte, arabishte, italishte, gjermanishte, anglishte, suedishte, hungarishte, rumanishte, rusishte, frëngjishte... me tufa poezish, ose në ndonjë gjuhë edhe me përmbledhje poezish.